



**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**  
**RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË**  
**“BASHKINË BULQIZË”**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**  
**“AUDITIM FINANCIAR MBI VEPRIMTARINË E BASHKISË BULQIZË”**

**TIRANË, SHTATOR 2024**

## Përmbajtja

|             |   |                                     |
|-------------|---|-------------------------------------|
| <b>I.</b>   | <b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....</b>  | <b>3</b>                            |
| a.          | Përshkrim i shkurtër i institucionit .....  | 3                                   |
| b.          | Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.....  | 3                                   |
| c.          | Objektivat dhe qëllimi i auditimit:.....  | 3                                   |
| d.          | Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit: .....  | 4                                   |
| e.          | Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.....   | 4                                   |
|             | <b>KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT .....</b>  | <b>5</b>                            |
| <b>II.</b>  | <b>HYRJE .....</b>  | <b>7</b>                            |
| 1.          | Objektivat dhe qëllimi.....   | 7                                   |
| 2.          | Identifikimi i çështjes: .....  | 7                                   |
| 3.          | Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar: .....   | 7                                   |
| 4.          | Përgjegjësia e audituesve të KLSH:.....   | 8                                   |
| 5.          | Kriteret e vlerësimit: .....  | 8                                   |
| 6.          | Standardet e auditimit .....  | 9                                   |
| 7.          | Metodologjia e auditimit .....  | 9                                   |
| 8.          | Dokumentimi i rezultateve të auditimit:.....  | 10                                  |
| <b>III.</b> | <b>PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.....</b>   | <b>10</b>                           |
| 1.          | <b>AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT .....</b>  | <b>10</b>                           |
| 2.          | <b>BURIMI I KRIJIMIT TË TË ARDHURAVE DHE MBLEDHJA E TYRE.....</b>   | <b>16</b>                           |
| 3.          | <b>AUDITIM MBI VLERËSIMIN E RAPORTIMIT FINANCIAR, PËR TË ARRITUR NË OPINIONIN NË SE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2023, JAPIN NJË PARAQITJE TË VËRTETË E TË DREJTË TË POZICIONIT FINANCIAR, PERFORMANCËS FINANCIARE DHE FLUKSIT TË PARASË, BAZUAR NË KUADRIN RREGULLATOR NË FUQI.....</b> | <b>25</b>                           |
| 4.          | <b>AUDITIM MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE MBI ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE (ASETE DHE PYJE E KULLOTA) TË TRASNFERUARA SIPAS VKM. ....</b>   | <b>55</b>                           |
| <b>III.</b> | <b>GJETJE DHE REKOMANDIME.....</b>  | <b>58</b>                           |
| A.          | MASA ORGANIZATIVE.....  | 58                                  |
| B.          | MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.....   | 65                                  |
| C.          | MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE .....   | 67                                  |
| D.          | MASA DISIPLINORE.....   | 67                                  |
| <b>IV.</b>  | <b>ANEKSE.....</b>  | <b>Error! Bookmark not defined.</b> |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### a. Përshkrim i shkurtër i institucionit

Bashkia Bulqizë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Bulqizë. 1.Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik: Zona Gjeografike: Bulqiza kufizohet në veri me Bashkinë e Dibrës, në perëndim me Bashkinë Klos, në jug-perëndim me Bashkinë Tiranë, në jug me Bashkinë Librazhd dhe në lindje me Republikën e Maqedonisë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Bulqizës. Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011 ka një popullsi prej 32,210 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 40,223 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 678.51 km<sup>2</sup> me një densitet prej 59.28 banorë/km<sup>2</sup> sipas Regjistrimit Civil dhe 47.47 banorë/km<sup>2</sup> sipas Censurit 2011. Të dhëna të tjera: Popullsia e Bulqizës është në shumicë dërmuese e besimit mysliman dhe një pakicë fare e vogël i përket besimeve të tjera. Relievi kodrinor-malor përcakton si burime kryesore gjeneruese bujqësinë dhe blegtorinë, por pa harruar edhe industrinë e nxjerrjes së kromit dhe atë të pasurimit të mineralit të kromit, ku rajoni i Bulqizës është mjaft i njohur. Ndërkohë, një tjetër burim i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të këtij rajoni konsiderohet edhe turizmi malor familjar si dhe ngritja e qendrave për grumbullimin e bimëve medicinale, me të cilat zona është mjaft e pasur. Projekte të mëdha të ndërmarra gjatë viteve të kaluara si asfaltimi i segmentit të rrugës nacionale “Qafa e Buallit- Shupenzë”, pjesë e Rrugës së Arbërit, si dhe hapjen e tunelit të po kësaj rruge në Qafën e Buallit me gjatësi 460 metër dhe trasenë Qafa e Buallit-Ura e Vashës kanë lehtësuar lëvizjen dhe transportin. Po kështu, investime të rëndësishme mund të konsiderojmë edhe sistemim asfaltimet e rrugëve rurale që lidhin qendrat e komunave Zerqan, Fushë-Bulqizë dhe Gjoricë, me rrugën nacionale. Qyteti i Bulqizës, i ndërtuar në funksion të minierës së kromit dhe rezervave të mëdha të kromit ka një numër të konsiderueshëm biznesesh, ndërsa numri i të punësuarve në minierë si dhe përfitimet ekonomike nga punësimi kanë variuar gjatë dekadave të fundit

### b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditimi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *“1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisve të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Bulqizë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### c. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga Bashkia Bulqizë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme

- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave.
- mbi shqyrtimin dhe dhënien e opinionit në përgatitjen e pasyrave financiare.

**d. Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

*Intervistimi* - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

*Raporte dhe informacione* - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikisht me drejtimit e auditimit;

*Verifikimi në sistemin elektronik* - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

*Të kombinuara*, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

**e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve**

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Bashkia Bulqizë për periudhën nën auditimit paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 19 gjetje dhe janë lënë 19 rekomandime. Në vijim paraqiten ato më kryesoret:

**f. Gjetjet kryesore:**

- Nga Lista e aseteve të kaluara në pronësi, rezulton se Bashkia Bulqizë ka të regjistruara dhe pajisur me çertifikatë vetëm 103 asete ose 7% të aseteve. Për asetet e mbetura, Bashkia Bulqizë nuk kryen inventarizim periodik të tyre, duke mos patur informacion për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, dëmtuara etj. Ndërkohë nuk rezulton të jenë marrë masa as për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të tyre për të vijuar me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të tyre.
- vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022 ka qenë 7,078 mijë lekë. Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur pagesa për këto detyrimeve, megjithatë nuk janë krijuar as detyrime të reja, duke rezultuar në një vlerë të detyrimeve të prapambetura deri 31.12.2023 në vlerën 7,078 mijë lekë.
- Nga llogaritjet e kryera nga grupi i auditimit, duke marrë në konsideratë vlerën totale të llogarive të klasës 3 për vitin 2023, të përbërë nga llogaria 31 dhe llogaria 32, kanë rezultuar diferencat përkatësisht në vlerat 452,864 lekë dhe 4,441,818 lekë. Ky fenomen ka sjellë një mbivlerësim të vlerave në pasqyrën e pozicionit financiar, për të dyja llogaritë.
- Vlera prej 7,078,668 lekë që përfaqëson shpenzime të kryera që i përkasin periudhave të ardhshme (bazuar edhe në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, pika 8) nuk është kontabilizuar si pjesë e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” me kundërparti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, por është kontabilizuar si pjesë e llogarive 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, duke sjellë që llogaria 486 dhe 467 në mbyllje të vitit ushtrimor të rezultojnë në vlerë 0 lekë.
- Llogaria 210 “Toka, troje, Terene”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën 4,926,397 lekë, si dhe në pasqyrën formati 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto”, duke moskuadruar me vlerën që rezulton bazuar në detajimin analitik të kësaj llogarie (kosto historike në fund), si dhe duke sjellë paraqitjen e

nënvlerësuar të kësaj llogarie për vlerën 267,179 lekë. Kjo për arsye se vlera prej 5,193,576 lekë që përfaqëson realisht totalin e kësaj llogarie, i është nënshtruar amortizimit me normë 5%, ndërkohë që kjo llogari nuk i nënshtrohet amortizimit.

- Nuk është kryer njohja dhe kontabilizimi i vlerës prej 42,132,697 lekë, me efekt të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë, e cila përbëhet nga taksa dhe tarifa vendore në vlerën 3,577,360 lekë, tarifa për licensimin e subjekteve që tregëtojnë hidrokarbure në vlerën 5,800,000 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,273,024 lekë, si dhe nga qiradhënia e pyjeve e kullotave në vlerën 31,482,313 lekë.

- Për vitin 2023 Bashkia Bulqizë ka krijuar debitorë të rinj në vlerën 8,490,431 lekë.

**g. Rekomandimet më kryesore** për përmirësimin e situatës lidhen me sistemimet përkatëse në llogaritë kontabël për mangësitë e konstatuara, masat për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, si dhe ato për arkëtimin e debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore si vijon:

- Bashkia Bulqizë, Drejtoria e Financës, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plane të detajuara për këtë qëllim dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike.

- Titullari i Bashkisë Bulqizë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura pa regjistruar cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillohet përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me çertifikatë pronësie.

- Masa për sistemimet dhe korrigjimet në llogaritë përkatëse kontabël të zërave të konstatuar me mangësi

- Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre në vlerën 99,933,852 lekë.

- Masa për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura dhe ndjekien e të gjitha rrugëve ligjore për këtë qëllim.

## KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

### **Opinioni mbi pasqyrat financiare:**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Bashkisë Bulqizë për periudhën ushtrimore 01.01.2023 - 31.12.2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Bulqizë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi t, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar, me rezervë**, e shprehur kjo në bazën për opinionin".

### **Baza për opinion e modifikuar, me rezervë:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA<sup>-të</sup>). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Bulqizë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 është 12,936 mijë lekë.

### **Përshkrimi i çështjeve:**

- Nga llogaritë e klasës 3 për vitin 2023, përbërë nga llogaria 31 “Materiale” dhe llogaria 32 “Inventar i imët”, kanë rezultuar diferencat përkatësisht në vlerat 452,864 lekë dhe 4,441,818 lekë, duke sjellë një mbivlerësim të vlerave në pasqyrën e pozicionit financiar, për të dyja llogaritë.

- Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit ushtrimor është mbivlerësuar në pasqyrën e pozicionit financiar, për vlerën 2,000 lekë.

- Gjendja e llogarieve 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” dhe llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, në fund të vitit ushtrimor 2023, nuk është paraqitur në mënyrë reale në pasqyrën e pozicionit financiar, duke sjellë një nënvlerësim të të dyja llogarive për vlerën 7,078,668 lekë.

- Vlera prej 4,865,108 lekë, pjesë e llogarisë analitike 202 “Studime dhe kërkime”, e cila përbëhet nga studime dhe kërkime të trashëguara nga ish Komunat (sot Njësitë Administrative) është e pa analizuar dhe nuk ka informacion nëse këto projekte janë vënë në zbatim.

- Llogaria 210 “Toka, troje, Terene”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën 4,926,397 lekë, duke sjellë paraqitjen e nënvlerësuar të kësaj llogarie për vlerën 267,179 lekë, pasi i është nënshtruar amortizimit, ndërkohë që kjo llogari nuk i nënshtrohet amortizimit.

- Nga llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” nuk është zbritur ende vlera prej 225,599,068 lekë për 1 (një) artikull të ujësjiellës - kanalizime që i është transferuar UK Bulqizë, duke sjellë ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me aktivet afatgjata materiale dhe të llogaritjes së amortizimit të tyre.

- Për aktivet në vlerën prej 11,955,591 lekë që kanë qenë pjesë e llogarisë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara”, nuk është ngritur një grup pune për t'i vlerësuar për jashtë përdorimit pasi ato ekzistojnë ende fizikisht, edhe pse janë hequr nga kontabiliteti.

- Amortizimi është nënvlerësuar për vlerën 200,483,667 lekë, si rrjedhojë e sistemimeve / lëvizje midis llogarive të aktiveve, që realisht në pasqyrën formati nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” janë reflektuar si pakësime.

- Procesi i inventarizimit në Bashkinë Bulqizë për vitin 2023 nuk është kryer për asnjë nga fazat e tij.

- Grupi i llogarive 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është mbivlerësuar për vlerën totale prej 7,771,619 lekë.

- Nuk është kryer njohja dhe kontabilizimi i vlerës prej 42,132,697 lekë, me efekt të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë, e cila përbëhet nga taksa dhe tarifa vendore në vlerën

3,577,360 lekë, tarifa për licensimin e subjekteve që tregëtojnë hidrokarbure në vlerën 5,800,000 lekë, taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 1,273,024 lekë, si dhe nga qiradhënia e pyjeve e kullotave në vlerën 31,482,313 lekë.

## **II. HYRJE**

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 897/1 Prot, datë 03.07.2024, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 04.07.2024 deri më datë 02.08.2024 në subjektin Bashkia Bulqizë, u krye auditimi financiar për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R.K, Përgjegjëse grupi
2. K i, Audituese
3. E. S, Audituese
4. A. D, Auditues
5. P. Sh, Audituese

### **1. Objektivat dhe qëllimi**

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

### **2. Identifikimi i çështjes:**

Projekt Raporti synon të identifikojë përbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të titullarëve dhe stafeve mbështetëse për realizimin e përgjegjësive publike.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe logaritidhënies.

Projekt Raporti i Auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset.

### **3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:**

Titullari i Bashkisë, dhe Nëpunësi Zbatues sipas rastit, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrin ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj. Gjithashtu, stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje

me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

#### **4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:**

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar me objekt: dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Bashkisë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit e KLSH marrin evidenca të besueshme, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e dala lidhur me organizimin, veprimtarinë, programin dhe funksionet e subjekteve nën auditim. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojnë.

#### **5. Kriteret e vlerësimit:**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

*Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:*

Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Ligji nr. 84/2023 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj.

Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”

Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;

VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;

Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;

Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;

UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj.;

Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.

Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;

Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”,

*Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:*

Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar me ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”;

VKM nr. 248, date 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësisve që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;

VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;

Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.;

Udhëzimi përbashkët i Ministrisë së Çështjeve Vendore dhe Ministrisë së Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;

Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar

VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;

VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;

Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

## **6. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Bulqizë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë: - ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”; si dhe ISSAI 4200; - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

## **7. Metodologjia e auditimit**

### 1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen

ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël. 4. Kontrolli i vlerësimit Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre. 5. Konfirmim nga të tretët Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

### 3. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Bulqizë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

### 4. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

## **8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:**

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjykimit profesional, si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Auditimi. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur vlerësimet / përfundimet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tij.

## **III. PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT**

### **1. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT**

Në zbatim të Programit të Auditimit nr. 897/1, datë 03.07.2024, pika 1, u auditua *planifikimi dhe zbatimi i planit të buxhetit, bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 993, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjet vjetore për buxhetin e shtetit të vitit 2023, si dhe aktet nënligjore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit.* Dokumentacioni që u shqyrtua për auditimin e kësaj pike të programit të auditimit është si vijon:

- PBA 2023-2025;
- Projekt-buxhetin e miratuar për vitin 2023;
- Vendimet e KB "Për miratimin e buxhetit të Bashkisë" për vitin 2023;
- Vendime të tjera të KB, në lidhje me ndryshimet buxhetore;
- Situacioni i shpenzimeve për vitin 2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;
- Situacioni i të ardhurave për vitin 2023 i rakorduar me Degën e Thesarit;

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- Raportimet në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë lidhur me detyrimet e prapambetura të Bashkisë;
- Informacion shkresor i përgatitur nga subjekti bazuar në kërkesat e hartuara nga grupi i auditimit.

### 1. Programimi i PBA-së 2023-2025

Për hartimin e PBA-së 2023-2025 nga Bashkia janë ndjekur dhe zbatuar hapat e më poshtëm:

- VKB nr. 406, datë 27.12.2022, "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt programit buxhetor afatmesëm 2023-2025 dhe buxhetit vjetor";
- VKB nr. 347, datë 24.06.2022, "Për miratimin e programit përgatitor Buxhetor Afatmesëm 2023-2025" konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 597/1 prot., datë 30.06.2022;
- Urdhër nr. 2430, datë 30.03.2022, "Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm për periudhën 2023-2025 të Bashkisë Bulqizë";
- Me shkresën nr. 3861 prot., datë 27.05.2022 është dërguar në MFE "Projekt Dokumenti i PBA për periudhën 2023-2025", dhe relacioni bashkëlidhur;
- VKB nr. 405, datë 27.12.2022 "Për miratimin përfundimtar të PBA 2023-2025 të Bashkisë Bulqizë" konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresë nr. 455 prot., datë 30.12.2022;
- Me shkresën nr. 336 prot., datë 19.01.2023 është dërguar në MFE "VKB nr. 405, datë 27.12.2022, "Për miratimin përfundimtar të PBA 2023-2025 të Bashkisë Bulqizë" dhe bashkëlidhur Instrumenti i Planifikimit Financiar, konfirmuar nga Prefektura e Qarkut Dibër me shkresë nr. 17/1, datë 05.01.2023.

### 2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura

Për vitin 2023 në Bashkinë Bulqizë buxheti është hartuar kryesisht mbi bazën e 19 programeve, përkatësisht: Aparati, Shërbimi Policor, MZSh, Zhvillimi Ekonomik, Shërbimi Bujqësor, Bordi Kullimit, Administrimi i Pyjeve, Menaxhimi i Mbetjeve, Planifikimi Urban Vendor, Shërbimi Publik Vendor, Qendra Kulturore, Arsimit Bazë, Arsimit Mesëm, etj.

Rezulton se buxheti i viteve 2023-2025 është miratuar sipas procedurave dhe kërkesave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar.

Tabela nr. II.1.1: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2023

| Planifikimi i të ardhurave 2023  |                    | Planifikimi i shpenzimeve 2023              |                    |
|--|--------------------|---|--------------------|
| Burimi i të ardhurave  | Vlera në 000/ lekë | Emërtimi i zërave                           | Vlera në 000/ lekë |
| Të ardhura të planifikuara për vitin 2023  | 92,510             | Art. 600 Paga                               | 247,898            |
| Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm e të planifikuara për shpenzim për vitin 2023 | 126,729            | Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 41,026             |
| <b>Total të ardhurat e veta</b>  | <b>219,239</b>     | Art.602 Shpenzime operative                 | 155,469            |
| Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar.   | 46,855             | Art.604 Transferime korrente të brendshme   | 12,000             |

|  |                |   |                |
|--|----------------|---|----------------|
| Të ardhura të trashëguara nga granti i kushtëzuar (transferua specifike 600, 601, 602 etj.). | 32,773         | 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë |                |
| Grant i ri i çelur për llogari të vitit 2023   | 334,815        | Art.230-231 Investime                             | 313,617        |
| Transfertë specifike e çelur për llogari të vitit 2023                                       | 154,931        | Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)                | 18,603         |
| <b>Total të ardhura nga transfertat e buxhetit te shtetit</b>                                | <b>569,374</b> |   |                |
| <b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>   | <b>788,613</b> | <b>TOTALI SHPENZIMEVE</b>                         | <b>788,613</b> |

*Tabela nr. II.1.2: Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshimet e buxhetit për vitin 2023*

| Planifikimi i të ardhurave për vitin 2023  |                                    |   |                   | Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2023               |                                    |   |  |
|--|------------------------------------|---|-------------------|--|------------------------------------|---|--|
| Burimi i të ardhurave  | Buxheti fillestar, miratuar me VKB | Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB | Vlera në 000/lekë | Emërtimi i zërave                                      | Buxheti fillestar, miratuar me VKB | Buxheti shtesë/pakësim, miratuar me VKB | Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë) |
|  | <b>1</b>                           | <b>2</b>                                | <b>1+2</b>        |  | <b>3</b>                           | <b>4</b>                                | <b>3+4</b>   |
| Të ardhura të planifikuara për vitin 2023  | 92,510                             |   | 92,510            | Art. 600 Paga  | 235,456                            | 12,442                                  | 247,898  |
| Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2023 | 126,729                            |   | 126,729           | Art. 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore           | 39,321                             | 1,705                                   | 41,026   |
| <b>Total të ardhurat e veta</b>  | <b>219,239</b>                     |   | <b>219,239</b>    | Art. 602 Shpenzime operative                           | 139,933                            | 15,536                                  | 155,469  |
| Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar  | 46,855                             |   | 46,855            | Art. 604 Transferime korrente të brendshme             | 12,000                             |   | 12,000   |
| Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike  | 32,773                             |   | 32,773            | Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë | 0                                  |   | 0  |
| Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2023   | 314,519                            | 20,296                                  | 334,815           | Art. 230-231 Investime                                 | 318,617                            | -5,000                                  | 313,617  |
| Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2023   | 150,544                            | 4,387                                   | 154,931           | Fondi Rezervë + Kontigjencës (609)                     | 18,603                             |   | 18,603   |
| <b>Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit</b>   | <b>544,691</b>                     |   | <b>544,691</b>    |  |                                    |   |  |
| <b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>   | <b>763,930</b>                     | <b>24,683</b>                           | <b>788,613</b>    | <b>TOTALI I SHPENZIMEVE</b>                            | <b>763,930</b>                     | <b>24,683</b>                           | <b>788,613</b>   |

### Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023

Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **788,613** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **646,819** mijë lekë, ose në masën **82%**.

Nga këto janë realizuar nga të ardhurat e veta 155,015 mijë lekë dhe vlera e mbuluar nga FZHR është **491,804** mijë lekë, ose **76%**. Nga këto, fondi i pagave (llogaria 600) është realizuar me 100%, sigurime shoqërore dhe shëndetësore (llogaria 601) është realizuar me 100%, shpenzimet operative (llogaria 602) është realizuar me 67%, transfertat korrente të brendshme (llogaria 604) është realizuar me 66%, dhe fondi i investimeve (llogaria 231) është realizuar me 49%. Realizimi i buxhetit sipas zërave paraqitet në mënyrë më të detajuar në tabelën në vijim.

*Tabela nr. II.1.3: Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2023*

|  |
|--|
| <b>Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia Bulqizë për vitin 2023, në mijë lekë</b> |
|--|

| Nr. | Përshkrimi i shpenzimeve<br>Bashkia pa njësitë vartëse   | Plani 2023     | Fakti 2023     | Realizimi në % | Vlera e mbuluar nga të ardhurat e veta (fakti) | Vlera e mbuluar nga FZHR dhe granti (fakti) |
|-----|--|----------------|----------------|----------------|--|---|
| 1   | Artikulli - 600 Paga                                     | 247,898        | 247,898        | 100%           |  | 247,898                                     |
| 2   | Artikulli – 601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore      | 41,026         | 41,025         | 100%           |  | 41,025                                      |
| 3   | Artikulli - 602 Shpenzime operative                      | 174,072        | 142,775        | 82%            | 47,672   | 95,103                                      |
| 4   | Artikulli - 604 Transferta korrente të brendshme         | 12,000         | 9,081          | 76%            | 3,081  | 6,000                                       |
| 5   | Artikulli - 606 Transferime tek buxhetet familjare (PAK) |                |                |                |  |   |
| 6   | Artikulli - 230 Projekte                                 |                |                |                |  |   |
| 7   | Artikulli - 231 Investime                                | 313,617        | 206,040        | 66%            | 104,262  | 101,778                                     |
|     | <b>TOTAL</b>   | <b>788,613</b> | <b>646,819</b> | <b>82%</b>     | <b>155,015</b>                                 | <b>491,804</b>                              |

Me VKB nr. 404, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresë nr. 10/1 prot., datë 09.01.2023.

Nga bashkia ndarja e plan buxhetit dhe detajimi në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Në këto programe buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së pakushtëzuar sektoriale, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuara nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve. Gjatë këtij viti, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar dhe rialokimeve të kryera nga vetë bashkia, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, me VKB nr. 55, datë 24.07.2023, “Për një shtesë në VKB nr. 404, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2023””, me VKB nr. 72, datë 30.11.2023, “Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 404, datë 27.12.2022 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2023””. Sipas përcaktimit të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 47<sup>1</sup>, ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 44<sup>2</sup>, Udhëzimi i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore" shtojca 4, pika c.

### **3. Saktësia e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit**

Për vitin 2023 planifikimi i buxhetit për zërin shpenzime është në vlerën **788,613** mijë lekë, ndërsa realizimi në vlerën **646,819** mijë lekë, ose në masën **82%**.

Nga këto janë realizuar nga të ardhurat e veta 155,015 mijë lekë dhe vlera e mbuluar nga FZHR është **491,804** mijë lekë, ose **76%**.

Nga Drejtoria e Financës është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt rakordimet përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të

<sup>1</sup> Kryetari i njësisë së qeverisjes vendore bën një analizë të plotë të zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor të çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, edhe propozimet përkatëse për ndryshimin e vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, që ka miratuar buxhetin e vitit. Procedura e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve të vendimit të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore është e njëjtë me atë të vendimit për miratimin e buxhetit vjetor.

<sup>2</sup> Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore është përgjegjës të paraqesë çdo vit një raport me shkrim të këshilli për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore, përfshirë dhe institucionet e saj të varësisë. Ky raport i paraqitet këshillit jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.



34, pika 1, “Jo më vonë se data 31 janar, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore paraqet për shqyrtim e miratim në këshill raportin për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave për: a) dy vitet para vitit buxhetor; b) vitin buxhetor; c) tre vitet e ardhshme buxhetore...”, neni 40, pika 3, “Projektbuxheti vjetor përfshin...informacion mbi gjendjen/stokun e borxhit të njësisë së vetëqeverisjes vendore...detyrimet kontingjente dhe mundësinë e shfaqjes së tyre si detyrime në vitin buxhetor pasardhës”. Udhëzim i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101, “Në miratimin e fondeve sipas programeve dhe zërave të shpenzimeve, më parë do të mbulohen detyrimet e papaguara nga viti i mëparshëm dhe pastaj fondet për të financuar veprimtarinë e vitit në vazhdim”.

### Mbi likuidimin e vendimeve gjyqësore në Bashkinë Bulqizë

*Tabela nr. II.1.5: Vendimet Gjyqësore - Bashkia Bulqizë, në lekë*

| Nr. | Emër mbiemër i paditësit | Nr. dhe data vendimit të Gj. Apelit | Vlera në lekë e dëshmperblimit, sipas vendimit të Gjykatës së Apelit | Pagesa e kryer gjatë vitit 2022 | Pagesa e kryer gjatë vitit 2023 | Detyrimi i ngelur në 31.12.2023 |
|-----|--------------------------|-------------------------------------|--|---------------------------------|---------------------------------|---------------------------------|
| 1   | B Xh                     | Vendim nr. 285, datë 26.04.2023     | 403,920  | -                               | 403,920                         | -                               |
| 2   | F L                      | Vendimi nr. 184, datë 23.03.2023    | 1,100,106  | -                               | 1,100,106                       | -                               |
| 3   | 2 SHPK                   |                                     | 6,884,754  |                                 | 6,884,754                       |                                 |
| 4   | V Xh                     | Vendim nr.434, datë 12.06.2023      | 1,171,986  | -                               | 1,171,986                       | -                               |
| 5   | G V                      | Vendimi Nr. 408, datë 18.05.2023    | 599,803  |                                 | 599,803                         |                                 |
| 6   | Xh B                     |                                     | 500,000  | 300,000                         | 167,354                         | 32,646                          |
|     | <b>Shuma totale</b>      |                                     | <b>10,660,569</b>  | <b>300,000</b>                  | <b>10,327,923</b>               | <b>32,646</b>                   |

**Nga auditimit konstatohet se:** vlera e detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore të rezulton në vlerën 10,660,569 lekë. Janë paguar detyrime në vlerën 10,627,923 lekë gjatë vitit 2022 dhe 2023. Në 31.12.2023 rezultojnë detyrime të prapambetura për vendimet gjyqësore në vlerë 32,646 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”.

### Vështirësia Financiare e Bashkisë Bulqizë

Në UMFE nr.26, datë 27.03.2019 “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”, trajtohet shkalla e vështirësisë financiare dhe menaxhimi i këtyre vështirësive.

Gjithashtu në ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, datë 27.04.2017, kreu XI vështirësitë financiare dhe masat për zgjidhjen e tyre, neni 55 Probleme Financiare, pika 1.

Për Bashkinë Bulqizë, totali i shpenzimeve të miratuara nga të ardhurat e veta me VKB për vitin 2023 ka vlerën 646,819,000 lekë, ndërsa stoku i detyrimeve të prapambetura më 31.12.2023, ka vlerën 7,078,668 lekë, sipas raportimit në MFE me shkresë nr. 1049 prot., datë 28.02.2024. Raporti i këtyre treguesve, pra raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura me shpenzimeve totale të miratuara, ka vlerën 0%, shifër që e klasifikon Bashkinë Bulqizë në njësi të qeverisjes vendore pa probleme financiare, paraqitur si në tabelën mëposhtë:

| N.R        | Emërtimi                  | Stokun vlerë           | Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në | Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së |
|------------|---------------------------|------------------------|--|--|
| <b>I</b>   | <b>Borxhe (a+b)</b>       | <b>0</b>               |  |  |
| <b>a</b>   | <b>Hua afatgjatë</b>      | <b>0</b>               |  |  |
| a,1        | Principali                |                        |  |  |
| a,2        | Interesi                  |                        |  |  |
| <b>b</b>   | <b>Hua afatshkurtër</b>   | <b>0</b>               |  |  |
| b,1        | Hua                       |                        |  |  |
| b,2        | Overdrafte                |                        |  |  |
| b,3        | Kreditë furnitorëve       |                        |  |  |
|            |                           |                        |  |  |
| <b>II</b>  | <b>Detyrime (a+b+c)</b>   | <b>0</b>               |  | <b>0,01%</b>                                     |
| <b>a</b>   | <b>Shpenzime korrente</b> | 7,078,688<br>FZHR AKUM |  |  |
| a,1        | Mallra dhe shërbime       |                        |  |  |
| a,2        | Paga dhe sigurime         |                        |  |  |
| a,3        | Të tjera                  |                        |  |  |
|            |                           |                        |  |  |
| <b>b</b>   | <b>Shpenzime kapitale</b> | <b>0</b>               |  |  |
| b,1        | Institucione buxhetore    |                        |  |  |
| b,2        | Subjekte private          |                        |  |  |
|            |                           |                        |  |  |
| <b>c</b>   | <b>Vendime gjyqësore</b>  | <b>0</b>               |  |  |
| c,1        | Marrëdhënie pune          |                        |  |  |
| c,2        | Mallra dhe shërbime       |                        |  |  |
| c,3        | Investime                 |                        |  |  |
| c,4        | Të tjera                  |                        |  |  |
|            |                           |                        |  |  |
| <b>III</b> | <b>Totali (I+II)</b>      | <b>7,078,668</b>       | <b>646,819,000</b>                             | <b>0,01%</b>                                     |

*Për sa më lart është mbajtur Akt konstatimi nr. 1 me Zj. F.M dhe Z. R.B*

## **2. BURIMI I KRIJIMIT TË TË ARDHURAVE DHE MBLEDHJA E TYRE**

Mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Bulqizë në bazë të programit të auditimit nr. 897/1 prot., datë 03.07.2024 , mbajtur akt konstatimi me datë 02.08.2024. U verifikuan dokumentacioni si më poshtë:

- 1.Evidencat e realizimit të planit të vitit 2023.
- 2.Rakordimet me agjentët e mbledhjes së të ardhurave për vitit 2023.
3. Regjistrat e subjekteve debitorë në 31.12.2023.
- 4.Evidencat për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.
- 5.Të tjera dokumente mbështetëse.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar rezultoi se:

Për vitin 2023 ka funksionuar Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat e Tarifat Vendore, ku sipas Strukturës organizative të miratuar me VKB nr 397, datë 30.11.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Dibër me shkresë nr. 1235/1, datë 09.12.2022 dhe sipas vendimit të Kryetarit të Bashkisë nr 19, datë 31.01.2022 “Për miratimin e strukturës organike, kategoritë, nivelin e pagave, klasën e pagave për çdo pozicion të administratës dhe Njësi shpënzuese në varësi të bashkisë”, me 8 nëpunës, nga të cilët 1 (një) Drejtor, 1(një) Përgjegjës Sektori dhe 5 Specialist, në fakt ka funksionuar me 1 (një) Drejtor , 1 (një) Përgjegjës Sektori nga data 02.10.2023 dhe 5 Specialist (1 specialist për biznesin për rregjistrim dhe vlerësimin, 1 specialist për familjarët dhe 3 specialist për terrenin.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi, subjekte që kanë ushtruar aktivitetet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

| Lloji Biznesit | Viti 2023      |                 |                    |                 |
|----------------|----------------|-----------------|--------------------|-----------------|
|                | Gjendja fillim | Biznese të reja | Biznese të mbyllur | Gjendja në fund |
| B. Vogël       | 435            | 38              | 89                 | 384             |
| B. Madh        | 172            | 10              | 11                 | 171             |
| Institucione   | 14             | -               | -                  | 14              |
| Gjithsej       | 621            | 48              | 100                | 569             |

Për vitin 2023, kanë ushtruar aktivitetet 569 subjekte (384 subjekte të biznesit të vogël, 171 subjekte të biznesit të madh dhe 14 subjekte të tjera institucione).

Paketa fiskale për periudhën objekt auditimi është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 397 datë 30.11.2022 “Për miratimin e Paketës Fiskale të vitit 2023”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut me shkresën nr. 1235/1 prot., datë 09.12.2022.

Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizimi i të ardhurave për taksat dhe tarifat vendore paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

| Nr | Lloji i taksës, tarifës                              | Plani Viti 2023 | Fakti Viti 2023 | Realizimi në % |
|----|--|-----------------|-----------------|----------------|
| I  | Të ardhurat nga taksat                               | 10,681,930      | 11,023,841      | 103            |
| 1  | Taksa Vendore mbi Biznesin e vogel                   | 350,000         | 162,177         | 46             |
| 2  | Taksa mbi Ndertesën                                  | 5,570,830       | 4,894,519       | 88             |
| a  | Biznesi  |                 |                 |                |
| b  | Familjarët   |                 |                 |                |
| 3  | Taksa mbi token bujqesore (Familjarët)               | 1,374,000       | 270,313         | 20             |
| 4  | Taksa mbi truallin                                   | 487,100         | 239,833         | 49             |
| 5  | Taksa Vendore ne sherbimin hotelier                  | 100,000         | 40,250          | 40             |
| 6  | Taksa ndikimit ne infrastukture nga ndertimet e reja | 2,350,000       | 4,773,329       | 203            |
| 7  | Taksa e tableles                                     | 450,000         | 643,420         | 413            |
| II | Te ardhura jo tatimore                               | 47,708,770      | 51,043,921      | 107            |
| 1  | Tarife pastrimi                                      | 22,341,600      | 27,358,840      | 122            |
| a  | Tarifa e pastrimit per familjet                      | 2,821,500       | -               | -              |
| b  | Tarifa e pastrimit per Institucionet                 | 880,000         | 800,000         | 91             |

|     |  |                   |                    |            |
|-----|--|-------------------|--------------------|------------|
| c   | Tarifa e pastrimit per biznesin                            | 18,640,100        | 26,558,840         | 142        |
| 2   | Tarife ndricimi  | 1,064,900         | 444,200            | 42         |
| a   | Tarifa per ndricimin publik nga familjet                   | 420,700           | -                  | -          |
| b   | Tarifa per ndricimin publik per institucionet              | 100,000           | 100,000            | 100        |
| c   | Tarifa per ndricimin publik per biznesin                   | 544,200           | 344,200            | 63         |
| 3   | Tarife Gjelbrimi   | 580,700           | 270,000            | 46         |
| a   | Tarifa per gjelberimin nga familjet                        | 210,000           | -                  | -          |
| b   | Tarifa per gjelberimin nga Institucionet                   | 80,000            | 80,000             | 100        |
| c   | Tarifa per gjelberimin nga bizneset                        | 290,600           | 190,000            | 65         |
| 4   | Tarifa per sherbimet administrative te bashkise            | 18,471,100        | 12,774,830         | 69         |
| a   | Tarifa per sherbimet administrative te bashkise            |                   |                    |            |
| b   | Tarifa e licensimit te veprimtarive te transportit         | 910,000           | 1,352,490          | 148        |
| c   | Tarifa e parkimit per mjetet dhe vendparkime publike       | 120,000           | 70,000             | 58         |
| d   | Tarifa per dhenie licence per tregtimin e naftes /nenprod. | 1,000,000         | 1,380,000          | 138        |
| e   | Tarifa per pyjet dhe kullotat                              | 16,041,100        | 9,707,740          | 61         |
| f   | Tarifa per sherbimet shtese nga zjarrfiksja                | 50,000            | -                  | -          |
| g   | Tarifa per zenien e hapësirës publike dhe fasadave         | 350,000           | 264,600            | 76         |
| 5   | Tarifa te institucioneve te arsimit,kultures,sportit etj   | 1,050,470         | 1,975,520          | 188        |
| a   | Qendra kulturore e femijeve                                | 50,000            | 5,000              | 10         |
| b   | Kopshtet   | 450,100           | 985,260            | 219        |
| c   | Çerdhet  | 550,370           | 985,260            | 179        |
| 6   | Tarifa per sherbimin e ujitjes dhe kullimit                | 100,000           | -                  | -          |
| 7   | Qeraja nga asetet ne pronesi te bashkise.                  | -                 |                    |            |
| 8   | Kundervajtjet administrative (Gjobat)                      | 600,000           | 193,720            | 32         |
| 9   | Te tjera (nga debitoret )                                  | 3,500,000         | 8,026,811          | -          |
| III | Të ardhura nga taksat e ndara                              | 34,700,000        | 52,757,369         | 139        |
|     | Taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve te perdorura       | 15,300,000        | 15,607,384         | 102        |
|     | Taksa e rentes minerare                                    | 12,520,000        | 25,460,906         | 203        |
|     | Taksa mbi te ardhurat personale                            | 6,880,000         | 11,689,079         | 170        |
|     | <b>Totali të ardhura 2023</b>                              | <b>93,120,000</b> | <b>114,825,131</b> | <b>123</b> |

Nga të dhënat e pasqyrës si më sipër rezulton se, për vitin 2023, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 93,120,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 114,825,131 lekë ose 123%, me një tejkalim në vlerën 21,705,131 lekë. Ky tejkalim vjen nga arkëtimi i disa taksave nga viti i mëparshëm kryesisht taksa e rentës me tejkalim në vlerën 12,940,906 lekë, tatimi mbi të ardhurat në vlerën 4,809,079 lekë dhe tarifa e pastrimit mbi biznesin në vlerën 7,918,740 lekë. Vlera e lartë e tejkalimit të realizimit të të ardhurave vjen si pasojë e mos planifikimit real të treguesve, duke qenë se Bashkia Bulqizë nuk disponon të dhëna të sakta mbi numrin e taksa paguesve dhe në këto kushte planifikimi bëhet përgjithësisht mbi baza historike, pra duke ju referuar realizimit të viteve të mëparshme.

Me mosrealizim paraqiten taksa për tokën e cila nga 1,374,000 lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 270,313 lekë ose 20%, Taksa mbi ndërtesat nga 5,570,830 lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 4,894,519 lekë ose 88%, Taksa e tabelës nga 1,000,000 lekë e planifikuar është realizuar në vlerën 643,420 lekë ose 64%.

Me mosrealizim paraqiten tarifate vendore (pastrami, ndriçim, gjelbrimi) nga familjarët nga 3,451,500 lekë pasi si agjent tatimor për mbledhjen e kesaj tarife me VKB është vendosur Ujësjeselles Bulqizë i cili gjatë vitit 2023 i është nënshtruar ristrukturimit dhe nuk është arritur të lidhet marrëveshje midis bashkisë dhe ujësjeselles.

Sa më sipër për taksat familjare nuk ka një regjistër për sipërfaqen e tokës së ndarë për çdo familje dhe sipërfaqet e ndërtesave të banimit, kështu planifikimi i tyre është bërë sipas realizimit të një viti më parë dhe jo mbi bazën e të dhënave që Drejtoria e të Ardhurave duhet të merrte nga regjistri elektronik i zyrës rajonale të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin taksave vendore” i ndryshuar neni 22, pika 1, ku përcaktohet se: Baza e taksës mbi ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit në metër katror e ndërtesës ose e pjesës së saj, mbi dhe nën nivelin e tokës dhe për çdo kat. Sipërfaqja në pronësi të taksapaguesit përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë këtë pronësi, neni 23, pika 1, ku përcaktohet se: Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë.

Nga të dhënat e Sektorit të Tatimit Taksave, për vitin 2023 të ardhurat për taksat dhe tarifate vendore të cilat mbledhen me agjent tatimorë paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

| Nr | Emërtimi   | Viti 2023   |            |
|----|--|-------------|------------|
|    |  | Plan        | Fakt       |
| 1  | Taksa Vendore mbi Biznesin e vogel                   | 350,000     | 162,177    |
| 2  | Taksa vjetore per qarkullimin e mjeteve te perdorura | 15,300,000  | 15,607,384 |
| 3  | Taksa e rentes minerare                              | 12,500,000  | 25,460,906 |
|    | Taksa mbi te ardhurat personale                      | 6,880,000   | 11,689,079 |
|    |  | 35,030,000  | 52,919,546 |
|    | <b>Realizimi</b>                                     | <b>151%</b> |            |

Përsa më sipër: Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, është planifikuar duke mos patur një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbyllet dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhiros do paguajnë tatimin e fitimit.

Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia Bulqizë.

Taksa e rentës është planifikuar sipas realizimit të vitit të mëparshëm po kështu dhe TAP është planifikuar sipas të dhënave të realizimit të një viti më parë.

Pra arkëtimet janë kryer pa pasur të dhëna mbi bazën e të cilave bëhen llogaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në pajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 117 dhe UMF Nr. 26, datë 4.9.2008 “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar.

### **Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2023.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve të taksave dhe tarifa vendore në vlerën gjithsej 99,933,852 lekë, janë 883 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën 80,256,366 lekë, si dhe 4298 familje për taksë toke, taksë ndërtese dhe tarifa vendore, në vlerën 19,677,486 lekë, si më poshtë:

| EMËRTIMI | 31.12.2022 | 31.12.2023 |
|----------|------------|------------|
|----------|------------|------------|

|                          | Vlera      | Nr. Subjekte e familje | Vlera      | Nr. Subjekte e familje |
|--------------------------|------------|------------------------|------------|------------------------|
| Debitorë ne total        | 91,443,421 | 1671                   | 99,933,852 | 5181                   |
| Biznesi i madh           | 46,060,830 | 105                    | 45,840,500 | 97                     |
| Biznesi i vogël          | 32,849,421 | 809                    | 34,415,866 | 786                    |
| Familje për taksa tarifa | 12,533,170 | 757                    | 19,677,486 | 4298                   |

Nga vlera totale e mësipërme rezulton se Bashkia Bulqizë ka njohur dhe kontabilizuar vlerën prej 96,356,492 lekë.

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se debitorët e vitit 2023 me vitin 2022 janë në rritje si në numër ashtu dhe në vlerë, kështu debitorë, për vitin 2023 të biznesit dhe familjarë janë 5181 subjekte të biznesit të vogël dhe të madh e familje në vlerën 99,933,852 lekë, krahasuar me vitin 2022 që kanë qenë 1671 subjekte të biznesit të vogël dhe të madh e familje në vlerën 91,443,421 lekë.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se struktura e borxhit për subjektet e biznesit të madh dhe biznesit të vogël, sipas moshës së tij paraqitet si mëposhtë:

| Mosha e Borxhit | 2023       |              |
|-----------------|------------|--------------|
|                 | Vlera      | Nr. Subjekte |
| Totali          |            |              |
| 1 vit           | 34,296,447 | 211          |
| 2 vjet          | 10,081,173 | 93           |
| 3 vjet          | 5,496,542  | 46           |
| 4 vjet          | 5,461,900  | 54           |
| 5 vjet          | 3,611,543  | 51           |
| Mbi 5 vjet      | 21,308,761 | 428          |
|                 | 80,256,366 | 883          |

Ndërsa sipas statusit të subjekteve gjendja e borxhit paraqitet në pasqyrën si mëposhtë:

| Stausi i subjekteve debitore | 2023       |              |
|------------------------------|------------|--------------|
|                              | Vlera      | Nr. Subjekte |
| Totali                       |            |              |
| Aktiv                        | 46,762,485 | 306          |
| Pasiv ose Mbyllur            | 33,493,881 | 577          |
|                              | 80,256,366 | 883          |

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se nga totali i subjekteve prej 883 që janë debitorë në vlerën 80,256,366 lekë, 306 subjekte janë aktiv dhe nuk kanë shlyer detyrimet në vlerën 46,762,485 lekë ose 58 % e totalit. Për këto raste i janë dërguar bankave te nivelit të dytë 265 urdhër bllokime në shumën 28,776,776 lekë, për të cilat janë ekzekutuar 49 urdhëra në vlerën 8,376,494 lekë.

Ndërsa vlera prej 19,677,486 lekë janë debitorë 4298 familje të për taksat e tarifave vendore me datë 31.12.2023, për mospagesën e detyrimeve sipas pasqyrës si mëposhtë:  
lekë

| Bashkia | Taksavendore |  |  |  |
|---------|--------------|--|--|--|
|         |              |  |  |  |

| N r |                 | TaksëTok e       | Taksë Ndërtese   | TarifaVendor + gjoba | Shuma taksa tarifa | Numri i familjeve |
|-----|-----------------|------------------|------------------|----------------------|--------------------|-------------------|
| 1   | Bulqiza         | 542,025          | 3,628,716        | 5,650,552            | 9,821,293          | 1669              |
| 2   | Fushe Bulqize   | 729,476          | 255,350          | 181,901              | 1,166,727          | 197               |
| 3   | Shupenze        | 1,115,860        | 689,512          | 701,191              | 2,506,563          | 789               |
| 4   | Gjorice         | 1,018,282        | 232,713          | 193,667              | 1,444,662          | 357               |
| 5   | Zerqan          | 855,462          | 629,040          | 487,148              | 1,971,650          | 585               |
| 6   | Kraste          | 200,557          | 281,397          | 278,220              | 760,174            | 288               |
| 7   | Ostren&Trebisht | 1,133,010        | 548,760          | 308,647              | 1,990,417          | 413               |
|     | <b>Shuma</b>    | <b>5,594,672</b> | <b>6,265,488</b> | <b>7,817,326</b>     | <b>19,677,486</b>  | <b>4298</b>       |

Konstatimi: Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave nga Taksat e Tarifave Vendore, Bashkia Bulqizë konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 883 subjekte në vlerën 80,256,366l ekë dhe 4298 familje për taksë toke, taksë ndërtese dhe tarifa vendore, në vlerën 19,677,486 lekë për të cilat edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 883 subjekte debitorë në vlerën 80,256,366 lekë, janë aktiv 306 subjekte ose 32 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa, në vlerën 46,762,485 lekë ose 60 % e vlerës së debitorëve. Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtitimit të debitorëve, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

#### **Nga auditimi për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë rezultoi se:**

Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Bulqizë për vitin 2023 nuk ka zbatuar përcaktimet ligjore të nenit 35, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, për sa i përket arkëtitimit të ardhurave për taksën e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë, që ndodhen në territorin e Bashkisë Bulqizë.

Referuar kapitullit II, pikës 1; germës “b” të VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj “i ndryshuar, në të përcaktohet që:

|   |
|---|
| <p>II. Procedura për dhënien e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë</p> <p>1.Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësive të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:</p> <p>b) Organet e qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësive të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë</p> |
|---|

veprimtarinë e tregimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, do të ndërtohen në territoret e tjera.

9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera.

- Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon: me vkm nr.344, dt. 19.4.2017.

"9. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera."

Sipas të dhënave nga Drejtoria e të Ardhurave, subjektet e tregimit të karburanteve që ushtrojnë aktivitetet me seli në territorin e Bashkisë Bulqizë, janë 9 (7 subjekte për shitjen karburanteve dhe 2 subjekte për shitjen e Gazit të lëngshëm) nga të cilët janë paisur me licensë 7 prej tyre dhe 2 subjekte nuk janë paisur me licensë si më poshtë:

| Nr. | Subjekti | Nipt    |
|-----|----------|---------|
| 1   | "T"shpk  | K....F  |
| 2   | "T"shpk  | L.....Q |

Nga auditimi për pagesat e kryera nga subjektet e licensuara rezulton se, 3 subjekte kanë likujduar detyrimin pjesërisht nga 3,000,000 lekë kanë likujduar 1,200,000 lekë pra më pak vlerën 1,800,000 lekë si më poshtë:

| Nr.          | Subjekti   | Nipt    | Afati I Autorizimit |            | Detyrimi për autorizimin | Pagesat e kryera | Diferenca        |
|--------------|------------|---------|---------------------|------------|--------------------------|------------------|------------------|
|              |            |         | Fillimi             | Mbarimi    |                          |                  |                  |
| 1            | "r"shpk    | L.....P | 19.11.2020          | 13.12.2024 | 1,000,000                | 600,000          | 400,000          |
| 2            | "t"shpk    | L.....S | 24.09.2021          | 23.09.2022 | 1,000,000                | 200,000          | 800,000          |
| 3            | "XH 2"shpk | L.....Q | 03.11.2021          | 03.11.2022 | 1,000,000                | 400,000          | 600,000          |
| <b>SHUMA</b> |            |         |                     |            | <b>3,000,000</b>         | <b>1,200,000</b> | <b>1,800,000</b> |

Nuk kanë kryer pagesë 4 subjekte në vlerën 4,000,000 lekë, të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

| Nr.          | Subjekti  | Nipt    | Afatii Autorizimit |            | Detyrimi për autorizimin | Pagesat e kryera | Diferenca        |
|--------------|-----------|---------|--------------------|------------|--------------------------|------------------|------------------|
|              |           |         | Fillimi            | Mbarimi    |                          |                  |                  |
| 1            | "M. "shpk | L.....T | 22.05.2015         | 21.05.2020 | 1,000,000                | 0                | 1,000,000        |
| 2            | "XH."shpk | L.....A | 01.02.2015         | 31.01.2020 | 1,000,000                | 0                | 1,000,000        |
| 3            | "M M"shpk | J.....I | 15.05.2015         | 14.05.2020 | 1,000,000                | 0                | 1,000,000        |
| 4            | "Jshpk    | K.....I | 26.05.2013         | 25.05.2018 | 1,000,000                | 0                | 1,000,000        |
| <b>SHUMA</b> |           |         |                    |            | <b>4,000,000</b>         | <b>0</b>         | <b>4,000,000</b> |

Konstatimi: Nga auditimi ka rezultuar se 9 subjekte ushtrojnë aktivitetet të tregimit të karburanteve me seli në territorin e Bashkisë Bulqizë, nga të cilët 2 subjektet "T"shpk, me Nipt K.....F, dhe "T"shpk me nipt L...Q nuk janë paisur me Autorizim/Licenca për shitje karburanti, ndërsa 7 subjekte të cilat janë paisur me Autorizim/Licenca 3 prej tyre kanë likujduar pjesërisht vlerën e

plotë dhe dhe 4 subjektet nuk kanë Likujduar detyrimet gjithsej në vlerën 4,000,000 lekë, subjekti “R OIL”shpk, me NIPT L.....P, në vlerën 600,000 lekë, “T”shpk me NIPT L.....S, në vlerën 800,000 lekë, “XH. 2013”shpk me NIPT L.....Q, në vlerën 800,000 lekë, “M. “shpk me NIPT L56602401T, në vlerën 1,000,000 lekë, “X.....A OIL”shpk, me NIPT L.....A, në vlerën 1,000,000 lekë, “M”shpk me NIPT J.....I, në vlerën 1,000,000 lekë dhe “J.I” shpk me NIPT K7.....I, në vlerën 1,000,000 lekë, e cila ka sjell të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Bulqizë në vlerë 5,800,000 lekë, gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të vitit 2023 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 5,800,000 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh” me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9.

### **Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë:**

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ALUIZNI Peshkopi janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi të destinuara për regjistrim në ASHK Peshkopi. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2023, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 44 persona me vlerë 1,273,024 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Bulqizë, rezulton se nga Drejtoria e të ardhurave, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3, të dhënat sipas pasqyrës aneks bashkëlidhur

Konstatimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Aluizni Peshkopi janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Peshkopi. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2023, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 44 persona me vlerë 1,273,024 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Bulqizë rezulton se nga Drejtoria e të ardhurave, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- Taksa e ndikimit në infrastrukturë, pika 3, gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës viti 2022 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 1,854,317 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

neni 22, pika 3, germa “dh” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale, të dhënat sipas pasqyrës Aneks bashkëlidhur.

### **Auditimi mbi likuidimin e detyrimeve nga dhënia me qira e sipërfaqeve pyjore dhe kullimore, për periudhën viti 2023.**

Nga Drejtoria e të Ardhurave për periudhën object auditimi administrohen 16 kontrata qiraje për dhënie me qira Pyje dhe Kullota me sipërfaqe 107.863 ha, me afate 10 dhe 35 vjeçare.

Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira e Pyjeve dhe Kullotave për kontratat e vitit 2023 e para, u konstatua se 7 subjekte nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën 31,482,313 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Bulqizë, sipas pasqyrës si më poshtë:

| Nr | Subjekti      | Kontrata |            | Sip ha       | Vlera kontratës | Detyrimi Deri 31.12.23 | Likujduar Deri 31.12.23 | Pa likujduar 31.12.23 |
|----|---------------|----------|------------|--------------|-----------------|------------------------|-------------------------|-----------------------|
|    |               | Nr       | Date       |              |                 |                        |                         |                       |
| 1  | E.            | 1824     | 15.05.2017 | 0.8          | 153,845         | 923,070                | 163,920                 | 759,150               |
| 2  | C.2016        | 1218     | 05.04.2017 | 8.9          | 217,510         | 1,305,060              | 780,000                 | 525,060               |
| 3  | A.i-Tre       | 435      | 08.02.2017 | 0.52         | 72,925          | 510,475                | 72,925                  | 437,550               |
| 4  | D.Tec         | 4082/2   | 15.11.2017 | 2.8          | 398,567         | 2,391,402              | 0                       | 2,391,402             |
| 5  | G. 1          | 1203     | 04.04.2017 | 0.47         | 266,072         | 1,330,360              | 550,017                 | 780,343               |
| 6  | G. 2          | 1202     | 04.04.2017 | 2.3          | 125,020         | 750,120                | 181,759                 | 568,361               |
| 7  | T. 2003       | 260      | 06.09.2012 | 7.36         | 3,488,345       | 34,883,450             | 8,520,590               | 26,362,860            |
|    | <b>Totali</b> |          |            | <b>23.15</b> |                 | <b>42,093,937</b>      | <b>10,269,211</b>       | <b>31,824,726</b>     |

Nga Drejtoria e të Ardhurave, nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve, nuk është dërguar informacion Drejtorisë Juridike me qëllim ndjekjen e rrugëve ligjore për arkëtimin e detyrimeve deri në zgjidhjen e kontratave me subjektet sipas pasqyrës si më sipër, gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të vitit 2023 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 31,824,726lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12, germa “g”, neni 22, pika 3, germa “dh” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale

Konstatimi: Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira e Pyjeve dhe Kullotave për kontratat e vitit 2023 e para, u konstatua se 7 subjekte nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën 31,482,313 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Bulqizë. Nga Drejtoria e të Ardhurave, nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve, nuk është dërguar informacion Drejtorisë Juridike me qëllim ndjekjen e rrugëve ligjore për arkëtimin e detyrimeve deri në zgjidhjen e kontratave me subjektet sipas pasqyrës si më sipër, gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës viti 2022 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 31,482,313lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12, germa “g”, neni 22, pika 3, germa “dh” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale.

*Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi zj. F.m dhe z. R. H.*

### **3. AUDITIM MBI VLERËSIMIN E RAPORTIMIT FINANCIAR, PËR TË ARRITUR NË OPINIONIN NË SE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2023, JAPIN NJË PARAQITJE TË VËRTETË E TË DREJTË TË POZICIONIT FINANCIAR, PERFORMANCËS FINANCIARE DHE FLUKSIT TË PARASË, BAZUAR NË KUADRIN RREGULLATOR NË FUQI.**

Për auditimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2023 u shqyrtua dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë Bulqizë, si vijon:

1. Pasqyra e pozicionit financiar (bilanci), viti 2023;
2. Pasqyra e performancës financiare (PASH), viti 2023;
3. Pasqyra e flukseve monetare, viti 2023;
4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto, viti 2023;
5. Pasqyra e investimeve dhe burimeve të financimit, viti 2023;
6. Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (kosto historike), viti 2023;
7. Pasqyra e gjendjes dhe ndryshimeve të aktiveve afatgjata (vlera neto), viti 2023;
8. Pasqyra e numrit të punonjësve dhe fondit të pagave, viti 2023; etj.

#### **Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm u konstatua:**

Në Bashkinë Bulqizë, janë hartuar dhe miratuar pasqyrat financiare për periudhën objekt auditimi, viti 2023.

- Bashkia Bulqizë për vitin 2023, ka përgatitur dhe dërguar brenda afateve ligjore pasqyrat financiare në Degën e Thesarit Bulqizë, me shkresë përcjellëse nr. 943 prot., datë 23.02.2024, protokolluar nga Dega e Thesarit Bulqizë me nr. 19/3 prot., datë 26.02.2024.
- Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë, për regjistrimin dhe kontabilizimin e veprimeve financiare nuk përdor asnjë program specifik financiar, por të gjitha regjistrimet, kontabilizimet dhe mbajtja e llogarive realizohet nëpërmjet Excel.

#### ▪ Pasqyra e pozicionit financiar – *Viti 2023*

- Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet – Pasivet = **3,641,719,372** lekë.
- Aktivet **3,934,387,672** lekë
- Pasivet **292,668,300** lekë
- Aktivet neto **3,641,719,372** lekë.

#### **Aktivët Afatshkurtra**

Aktivët afatshkurta më datë **31.12.2023** janë paraqitur në vlerën **497,312,066** lekë dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën **200,658,673** lekë;
- Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën **62,849,475** lekë;
- Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën **233,803,918** lekë;
- Llogaria e Klasës 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën **0** lekë.

#### **Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre”, përbëhet nga:**

Gjendja e llogarisë nr. 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas mbylljes së pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2023 është në vlerën **200,658,673** lekë, e cila rakordon me pasqyrën e flukseve monetare (cash floë) rubrika V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” në vlerën **210,571,173** lekë dhe rubrika VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në vlerën **200,658,673** lekë, ku

kjo e fundit përbëhet nga vlera e llogarisë 520 (sipas formatit F3 “Pasqyra e flukseve monetare”). Gjithashtu është paraqitur edhe detajimi analitik për fondet e trashëguara, pjesë e llogarisë 520 në fund të vitit 2023 (aneksi nr. 1, tabela nr.1).

#### **Gjendje Inventari qarkullues**

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Bulqizë në 31.12.2023 janë paraqitur në vlerën **62,849,475** lekë dhe përbëhen nga llogaria 31 “Materiale” në vlerën **22,894,784** lekë dhe nga llogaria 32 “Inventar i imët” në vlerën **39,954,691** lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën (**11,185,883**) lekë, e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në vlerën **11,185,883** lekë.

*Llogaritë e klasës 3 “Gjendje e inventarit qarkullues”, viti 2023*

| <b>Llogaritë kontabël</b> | <b>Emërtimi i llogarive</b>                 | <b>Viti 2023</b>  | <b>Viti 2022</b>  | <b>Diferenca 2023 – 2022</b> |
|---------------------------|---|-------------------|-------------------|------------------------------|
| <b>31</b>                 | Materiale                                   | 22,894,784        | 16,150,719        | 6,744,065                    |
| <b>32</b>                 | Inventar i imet                             | 39,954,691        | 35,512,873        | 4,441,818                    |
| <b>33</b>                 | Prodhim nre proces                          | -                 | -                 | -                            |
| <b>34</b>                 | Produkte                                    | -                 | -                 | -                            |
| <b>35</b>                 | Mallra                                      | -                 | -                 | -                            |
| <b>36</b>                 | Kafshe ne rritje e majmeri                  | -                 | -                 | -                            |
| <b>37</b>                 | Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve | -                 | -                 | -                            |
| <b>38</b>                 | Diferenca nga cmimet e magazinimit          | -                 | -                 | -                            |
| <b>39</b>                 | Provigjone per zhvlersimin e inventarit (-) | -                 | -                 | -                            |
| <b>TOTALI</b>             |   | <b>62,849,475</b> | <b>51,663,592</b> | <b>11,185,883</b>            |

**Llogaria 31 “Materiale”** për vitin 2023, ka vlerën 22,894,784 lekë dhe **Llogaria 32 “Inventar i imët”**, ka vlerën 39,954,691 lekë.

*Lëvizjet e llogarive të klasës 3 “Gjendje e inventarit qarkullues”, viti 2023*

| <b>Viti 2023</b>                         |                   |                   |
|--|-------------------|-------------------|
| <b>Llogaria</b>                          | <b>Llog. 31</b>   | <b>Llog. 32</b>   |
| Gjendja në fillim të vitit               | <b>16,150,719</b> | <b>35,512,873</b> |
| Hyrjet                                   | 67,772,788        | -                 |
| Daljet                                   | 61,481,587        | -                 |
| Gjendja në fund të vitit                 | <b>22,441,920</b> | <b>35,512,873</b> |
| Pasqyra e pozicionit financiar (Balanci) | <b>22,894,784</b> | <b>39,954,691</b> |
| <b>Diferenca</b>                         | <b>452,864</b>    | <b>4,441,818</b>  |

Nga të dhënat e Drejtorisë së Financës në Bashkinë Bulqizë, të vëna në dispozicion grupit të auditimit, konstatohet se nuk janë mbajtur llogari analitike për secilën nga këto llogari, duke e bërë të vështirë identifikimin se çfarë është përfshirë në llogarinë 31 dhe 32, si dhe lidhjen e tyre me vlerat në ditarin e magazinës. Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 7, pika 2<sup>3</sup> dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar.

Nga llogaritjet e kryera nga grupi i auditimit, duke marrë në konsideratë vlerën totale të llogarive të klasës 3 për vitin 2023, të përbërë nga llogaria 31 dhe llogaria 32, kanë rezultuar diferencat

3 2. Për çdo regjistrim kontabël duhet të shkruhet origjina, natyra, data dhe përmbajtja e veprimit ose e ngjarjes ekonomike.

përkatësisht në vlerat 452,864 lekë dhe 4,441,818 lekë. Këto veprime janë në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 11, pika 1; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar, Kapitulli III, pika 24; Ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

### **Konkluzion:**

Për vitin 2023 nisur nga moskuadrimi dhe rrjedhimisht diferencat që kanë rezultuar, vihet re se gjendja në fund të vitit e llogarive të klasës 3, duke marrë parasysh gjendjen në fillim, hyrjet dhe daljet e paraqitura në ditarin e magazinës, nuk përkon me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar. Këto veprime janë në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, neni 11, pika 1; Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar, Kapitulli III, pika 24; Ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

### **Llogaritë e Arkëtueshme**

**Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”** për vitin 2023, është paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar në vlerën **196,078,874** lekë. Shtesat për këtë llogari gjatë vitit përbëhen nga vlera e gjobave prej 64,860,486 lekë, ndërsa arkëtime (pakësime) janë realizuar në vlerën 8,068,012 lekë.

*Shtesa e debitorëve për vitin 2023*

| Nr.           | Emërtimi  | Vlera             |
|---------------|---|-------------------|
| 1             | Punime te pa kryera ne objekt                         | 4,233,735         |
| 2             | Takse e ndertimit Infrastrukture KLSH 2022            | 1,020,005         |
|          | 377              | 19.07.2023 | 7/2023     | 13.07.2023 | 6,269,520       | 6,269,520         |
|          | 719              | 28.12.2023 | 8/2023     | 04.12.2023 | 1,027,320       | 1,027,320         |
|          | 93               | 21.02.2023 | 2/2023     | 16.01.2023 | 2,395,920       | 1,500,000         |
|          | 94               | 21.02.2023 | 2/2023     | 16.01.2023 |                 | 895,920           |
|          | 370              | 17.07.2023 | 29/2023    | 21.06.2023 | 2,369,604       | 1,500,000         |
|          | 371              | 17.07.2023 | 29/2023    | 21.06.2023 |                 | 869,604           |
|          | 144              | 10.03.2022 | 67/2022    | 26.07.2022 | 30,000,000      | 30,000,000        |
|          | 720              | 29.12.2023 | 39/2023    | 01.06.2023 | 98,884,896      | 98,884,896        |
|          | 192              | 13.04.2023 | 11/2023    | 15.03.2023 | 500,000         | 500,000           |
|          | 721              | 29.12.2023 | 127/2023   | 22.12.2023 | 1,891,893       | 1,891,893         |
|          | 96               | 21.02.2023 | 3/2023     | 18.02.2023 | 18,000          | 18,000            |
|          | 384              | 21.07.2023 | 3/2023     | 27.06.2023 | 9,500           | 9,500             |
|          | 383              | 21.07.2023 | 4/2023     | 27.06.2023 | 90,000          | 90,000            |
|          | 114              | 06.03.2023 | 5/2023     | 20.02.2023 | 291,655         | 291,655           |
|          | 426              | 04.09.2023 | 17/2023    | 23.07.2023 | 111,840         | 111,840           |
|          | 117              | 06.03.2023 | 4/2023     | 20.02.2023 | 72,000          | 72,000            |
|          | 114              | 06.03.2023 | 5/2023     | 20.02.2023 | 291,655         | 291,655           |
|          | 306              | 13.06.2023 | 15/2023    | 04.06.2023 | 153,243         | 153,243           |
|          | 97               | 21.02.2023 | 5/2023     | 18.02.2023 | 600,000         | 600,000           |
|          | 299              | 13.06.2023 | 15/2023    | 04.06.2023 | 291,873         | 291,873           |
|          | 425              | 04.09.2023 | 16/2023    | 23.07.2023 | 72,000          | 72,000            |
|          | 670              | 18.12.2023 | 35/2023    | 04.11.2023 | 250,511         | 250,511           |
|          | 214              | 76         | 14.02.2023 | 3/2023     | 20.01.2023      | 191,880           |
| 91       |                  | 21.02.2023 | 4/2023     | 08.02.2023 | 120,000         | 120,000           |
| 660      |                  | 14.12.2023 | 27/2023    | 27.09.2023 | 743,880         | 743,880           |
| 537      |                  | 19.10.2023 | 27/2023    | 27.09.2023 | 433,440         | 433,440           |
| 215      | 202              | 14.04.2023 | 5/2023     | 12.04.2023 | 4,440,000       | 4,440,000         |
| 218      | 699              | 21.12.2023 | 15/2023    | 15.12.2023 | 719,820         | 719,820           |

|               |     |            |         |            |                    |                    |
|---------------|-----|------------|---------|------------|--------------------|--------------------|
|               | 615 | 21.11.2023 | 27/2023 | 31.05.2023 | 783,552            | 783,552            |
| <b>TOTALI</b> |     |            |         |            | <b>352,232,069</b> | <b>351,625,755</b> |

### **Në lidhje me Inventarizimin e aseteve:**

Nga auditimi evidentohet se procesi i inventarizimit në Bashkinë Bulqizë për vitin 2023 nuk është kryer, referuar gjithashtu faktit se nuk është hartuar asnjë urdhër për nisjen e këtij procesi dhe për vijimin me fazat e tjera si inventarizimi fizik, vlerësimi i gjitha aktiveve, si dhe nxjerrja jashtë përdorimi e më tej asgjë sipas nevojës. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pikat 73 – 120.

### **Konkluzion:**

Në Bashkinë Bulqizë, si rrjedhojë e mosrealizimit të procesit të inventarizimit duke përfshirë të gjitha fazat e tij, nuk është hartuar dhe miratuar një raport i inventarizimit fizik, që të përshkruajë kushtet e ruajtjes së aktiveve, duke specifikuar se cilat aktive pas mbarimit të procesit të inventarizimit fizik kanë rezultuar të dëmtuara, të amortizura ose plotësisht të amortizuara etj. Pra nuk ka pasur një verifikim fizik për aktivet, pjesë e inventarit të vitit 2023, gjë e cila pengon edhe verifikimin e gjendjes konkrete të aktiveve, krahasuar me rezultatin e aktiveve në kontabilitet. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli III Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes së tyre, pika 85<sup>6</sup>.

Përsa i takon aktiveve të Bashkisë Bulqizë nuk është përgatitur dhe miratuar një regjistër aktivësh i përditësuar. Ky veprim është në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kapitulli III Rregjistri i aktiveve dhe dokumentimi i levizjes së tyre, pikat 26 – 33.

Në Bashkinë Bulqizë nuk është hartuar dhe miratuar një rregullore specifike për ndjekjen e procedurave të ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike. Ky veprim është në mospërputhje me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Neni 8, pika ç); Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar rubrika Përgjegjësia e Titullarit të njësisë publike, pika 5<sup>7</sup>.

### **Investime për aktive afatgjata**

**Llogaria 231 “Investime për Aktive Afatgjata materiale”**, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën **370,843,486** lekë, ndërsa **Llogaria 230 “Investime për Aktive Afatgjata jomateriale”** është paraqitur në vlerën **0** lekë.

- **Llogaria 230 “Investime për Aktive Afatgjata jomateriale”**, në pasqyrën formati 6 “Investimet dhe burimet e financimit” është paraqitur me tepricë në fund në vlerën **0** lekë.
- **Llogaria 231 “Investime për Aktive Afatgjata materiale”**, në pasqyrën formati 6 “Investimet dhe burimet e financimit” është paraqitur me tepricë në fund në vlerën **370,843,486** lekë.

6 85. Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për: c. Te perploteje një raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzoje për veprime të metejshme Nepunesit Autorizues.

7 5. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për miratimin e rregullave specifike dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen, dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi.

Vlera prej **370,843,486** lekë përfaqëson totalin e aktiveve të papërfunduara (në proces) deri në 31.12.2023. Për vitin 2023 shtesa e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 233,269,370 lekë.

*Llogaria analitike 231 "Investime"(në proces), viti 2023*

| Nr.           | Përshkrimi   | Vlera në lekë e kontratës | Aktive në proces nga viti 2023 | Aktive në proces nga viti 2022 | Aktive në proces gjithsej në 31.12.2023 |
|---------------|--|---------------------------|--------------------------------|--------------------------------|---|
| 1             | Rikonstruksion Fusha e Futbollit (Ndertim i dhomave te zhveshjes se Futbollisteve)   | 10,178,372                | 5,595,660                      | 2,200,000                      | 7,795,660                               |
| 2             | Rikonstruksion Muzeu Qytetit dhe Sistemim i Sheshit Perpara  | 29,663,425                | 11,248,105                     | -                              | 11,248,105                              |
| 3             | Ndertim rrjeti shperndares i fshatrave Gjorice si dhe ndertim Depo uji faza 2 "  | 229,381,015               | 35,000,000                     | 89,861,764                     | 124,861,764                             |
| 4             | Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Topojan  | 13,953,756                | 9,767,232                      | 2,999,484                      | 12,766,716                              |
| 5             | Sistemim Asfaltim i Rruges se fshatit Peladhi  | 9,763,687                 | 7,136,640                      | 2,099,916                      | 9,236,556                               |
| 6             | "Ndertim Sistemim Kanalizimesh dhe impianti trajtim te ujerave te ndotura necqytetin Bulqize Lagjja e Re"                                      | 239,990,257               | 108,000,000                    | -                              | 108,000,000                             |
| 7             | Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Bllace, Nj.Ad.Shupenze (Loti I )   | 34,379,213                | 7,003,769                      | -                              | 7,003,769                               |
| 8             | Sistemim asfaltim i rruges se Varezave, qyteti Bulqize   | 13,912,693                | 5,000,000                      | -                              | 5,000,000                               |
| 9             | Ndertim rrjeti furnizimi dhe rrjeti shperndares ujesjellesi lagjja Allmete dhe ndertim i rrjetit KUZ Lagjja e vjeter, Qyteti Bulqize           | 387,809,573               | 21,470,440                     | 15,000,000                     | 36,470,440                              |
| 10            | Mbikqyrje Ndertim rrjeti furnizimi dhe rrjeti shperndares ujesjellesi lagjja Allmete dhe ndertim i rrjetit KUZ Lagjja e vjeter, Qyteti Bulqize | -                         | 200,000                        | 200,000                        | 400,000                                 |
| 11            | Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Sopot Loti II  | 11,999,999                | 10,068,924                     | -                              | 10,068,924                              |
| 12            | Rehabilitim Kanali ujitës (Sifoni ) Vajkal   | 18,948,443                | 7,502,887                      | -                              | 7,502,887                               |
| 13            | Sistemim asfaltim i rruges se Krajke e Siperme Nj. Ad. Zerqan  | 12,575,172                | 2,600,000                      | -                              | 2,600,000                               |
| 14            | Mbikqyrje punimesh "Rikonstruksion Muzeu Qytetit dhe sistemit Sheshi perpara"  | 479,159                   | 300,000                        | -                              | 300,000                                 |
| 15            | Mbikqyrje pjesore te objektit"Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Peladhi"   | 219,900                   | 208,905                        | -                              | 208,905                                 |
| 16            | Mbikqyrje pjesore te objektit"Sistemim asfaltim i rruges se fshatit Topojan"   | 292,398                   | 266,083                        | -                              | 266,083                                 |
| 17            | Mbikqyrje pjesore "Ndertim Sistemim Kanalizimesh dhe impianti trajtim te ujerave te ndotura necqytetin Bulqize Lagjja e Re"                    | 3,281,524                 | 740,000                        | -                              | 740,000                                 |
| 18            | Mbikqyrje punimesh "Ndertim rrjeti shperndares I fshatrave Gjorice si dhe ndertim depo uji-faza 2"   | 3,022,798                 | 500,000                        | 200,000                        | 700,000                                 |
| 19            | Mbikqyrje punimesh "Sistemim asfaltim i rruges Sopot Loti II "   | 231,086                   | 200,000                        | -                              | 200,000                                 |
| 20            | Mbikqyrje punimesh "Rehabilitim i kanalit ujitës (Sifoni )Vajkal   | 501,699                   | 200,000                        | -                              | 200,000                                 |
| 21            | Mbikqyrje objekti "Sistemim asfaltim i rruges se Krajke e Siperme" Nj.Ad.Zerqan  | 260,725                   | 260,725                        | -                              | 260,725                                 |
| 22            | Ndertim i linjes kryesore te ujesjellesit Burimet e Ganiut, Tucep-Cereneç  | -                         | -                              | 24,716,136                     | 24,716,136                              |
| 23            | Mbikqyrje punimesh Ndertim i linjes kryesore te ujesjellesit Burimet e Ganiut , Tucep-Cereneç  | -                         | -                              | 296,818                        | 296,818                                 |
| <b>TOTALI</b> |  | <b>1,020,844,894</b>      | <b>233,269,370</b>             | <b>137,574,118</b>             | <b>370,843,488</b>                      |

**Pasivet (Detyrimet)**

***Pasivet Afatshkurtra***

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të pasqyrës së pozicionit financiar, janë llogari të pagueshme, të cilat paraqesin detyrimet e Bashkisë Bulqizë deri në 31.12.2023, si pagat e punonjësve të muajit dhjetor, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

*"Llogaritë e klasës 4", viti 2023*

| Llogaritë | Emërtimi                             | Viti 2023  | Viti 2022  | Diferenca 2023 - 2022 |
|-----------|--------------------------------------|------------|------------|-----------------------|
| 401-408   | Furnitore e llogari te lidhura me to | 10,577,922 | 14,953,026 | (4,375,104)           |
| 42        | Detyrime ndaj personelit             | 22,388,364 | 15,682,988 | 6,705,376             |

|                 |  |                    |                    |                   |
|-----------------|--|--------------------|--------------------|-------------------|
| <b>16,17,18</b> | Hua Afat shkurtra                                    | -                  | -                  | -                 |
| <b>460</b>      | Huadhenes  | -                  | -                  | -                 |
| <b>431</b>      | Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa                | 1,014,473          | 731,668            | 282,805           |
| <b>432</b>      | Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal         | -                  | -                  | -                 |
| <b>433</b>      | Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore                  | -                  | -                  | -                 |
| <b>435</b>      | Sigurime Shoqerore                                   | 3,363,134          | 4,920,102          | (1,556,968)       |
| <b>436</b>      | Sigurime Shendetsore                                 | 381,151            | 316,307            | 64,844            |
| <b>437,438,</b> | Organizma te tjere shteterore                        | -                  | -                  | -                 |
| <b>44</b>       | Institucione te tjera publike                        | -                  | -                  | -                 |
| <b>45</b>       | Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike | -                  | -                  | -                 |
| <b>464</b>      | Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere            | -                  | -                  | -                 |
| <b>466</b>      | Kreditore per mjete ne ruajtje                       | 58,864,382         | 53,872,657         | 4,991,725         |
| <b>467</b>      | Kreditore te ndryshem                                | -                  | 7,738,273          | (7,738,273)       |
| <b>4341</b>     | Operacione me shtetin (detyrime)                     | 196,078,874        | 139,284,400        | 56,794,474        |
| <b>49</b>       | Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)              | -                  | -                  | -                 |
| <b>TOTALI</b>   |  | <b>292,668,300</b> | <b>237,499,421</b> | <b>55,168,879</b> |

Llogaritë e klasës 4 për vitin 2023 janë paraqitur në vlerën totale prej **292,668,300** lekë. Kjo vlerë ka rezultuar si rrjedhojë e llogarive përbërëse si më poshtë vijon:

• **Llogaritë 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”**, janë paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **10,577,922** lekë.

Detajimi i llogarive 401 – 408 paraqitet në tabelën si vijon në vlerën totale 10,577,922 lekë.

#### **Konkluzion:**

Nga auditimi evidentohet se, nga detajimi analitik i llogarisë 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, dy zëra (nr. 1 dhe 10 në tabelë) në vlerën 692,951 lekë nuk i përkasin këtij grupi të llogarive, pasi janë detyrime për paga dhe tatimet për paga. Gjithashtu evidentohet se në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit 2023, për zërat me nr. 20, 21 dhe 22 (në tabelë) në vlerën totale prej 7,078,668 lekë, theksohet se i përkasin llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, e cila ka si kundërparti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Pra këto zëra nuk bëjnë pjesë në llogaritë 401 – 408 (siç është argumentuar edhe më lart në material). Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” të ndryshuar, pika 3.3 Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4).

Detajimi i llogarive 401 - 408 “Furnitorë e llogari te lidhura me to”, viti 2023

| Nr. | Emri i Furnitorit        | Emri i kontratës   | Vlera e mbetur në 31.12.2023 |
|-----|--------------------------|--|------------------------------|
| 1   | Bashkia Bulqize          | Shperblim Keshilltare + Kryetare fshati muaji dhjetor 2023                               | 576,131                      |
| 2   | Sh.A.Ujesjellesi Bulqize | Faturim uji I pijshem muaji dhjetor 2023   | 395,198                      |
| 3   | OSSHE                    | Fatura energjie muaji dhjetor 2023   | 831,020                      |
| 4   | Sh.A.Posta Buqize        | Fatura sherbimi postar dhjetor 2023  | 360,705                      |
| 5   | D Xh                     | Blerje pjese kembimi per eskavator VOLVO   | 99,000                       |
| 6   | A.B.PF                   | Kolaudim punimesh ne objektin "Ndertime terene sportive shkolla 9-vjecare Xhevdet Doda"  | 21,422                       |
| 7   | A BPF                    | Kolaudim punimesh ne objektin "Nsistemim asfaltim I rruges fshati Krrajke" Nj.Ad.Zerqan. | 22,501                       |
| 8   | A B PF                   | Kolaudim punimesh ne objektin "Sistemim asfaltim I rruges se fshatit Bllace (Loti I)"    | 52,620                       |

|               |                       |  |                   |
|---------------|-----------------------|--|-------------------|
| 9             | Aj B PF               | Kolaudim punimesh ne objektin "Sistemim asfaltim I rruges se varrezave Bulqize"                | 24,504            |
| 10            | DPT BULQIZE           | Tatim shperblimi keshilltare + kryetare fshati, mirmbajtje antene, kontrata qeraje             | 116,820           |
| 11            | Bashkia Bulqize       | Qera Objekti muaji dhjetor 2023  | 102,850           |
| 12            | Bashkia Bulqize       | Ruajtes televiziv,mirmbajtje antenemaji dhjetor 2023   | 10,200            |
| 13            | FSASH                 | KUOTIZACION SINDIKATE Dhjetor 2023   | 6,000             |
| 14            | O.T                   | Detyrim telefoni per muajin Dhjetor 2023   | 26,871            |
| 15            | 2 .D                  | Kolaudim punimesh "Sistemim asfaltim I rruges lagja Kullas Okshatine                           | 24,612            |
| 16            | A. Sh.p.k             | Blerje materiale pune per punonjesit e qendres PAK dhe F.S.Sherbimi Social                     | 480,000           |
| 17            | C.shpk                | Urdher ekzekutiv per punonjesin Sefedin lala   | 6,000             |
| 18            | Z.Permbarimit.Q. shpk | Detyrim permbarimor per znj.Bajame Kodra   | 10,000            |
| 19            | SH.SHPK               | "Sistemim asfaltim I Rruges se Varrezave, Bulqize"   | 332,800           |
| 20            | c.sh                  | Rikonstrukcion i Shkolles se Mesme te Pergjithshme Bashkia Bulqize                             | 3,415,908         |
| 21            | GJ.K                  | Rruga Pedonale dhe rikonstruksonmi godinave + Unaza e poshtme Qyteti I vjeter, Bashkia Bulqize | 1,439,309         |
| 22            | E. SHPK               | Ndertim I Ujesjellesit fshati Peladhi,Bashkia Bulqize  | 2,223,451         |
| <b>TOTALI</b> |                       |  | <b>10,577,922</b> |

Lëvizjet e llogarive 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", viti 2023

| Lëvizjet e llog. 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" | Vlera në lekë     |
|---|-------------------|
| Celje e vitit 2023  | 14,953,026        |
| Shtesa (K)  | -                 |
| Pakësime (D)  | 4,375,104         |
| <b>Gjendja në 31.12.2023 (K)</b>                                | <b>10,577,922</b> |

• **Llogaria 42 "Detyrime ndaj personelit"**, është paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **22,388,364** lekë.

Llogara analitike 42 "Detyrime ndaj personelit", viti 2023

| Urdhër shpenzimi |            | Vlera në lekë     |
|------------------|------------|-------------------|
| Nr.              | Datë       |                   |
| 2                | 16.01.2024 | 6,093,109         |
| 3                | 16.01.2024 | 449,085           |
| 4                | 16.01.2024 | 1,439,917         |
| 5                | 16.01.2024 | 103,594           |
| 6                | 16.01.2024 | 479,105           |
| 7                | 16.01.2024 | 190,105           |
| 8                | 16.01.2024 | 565,757           |
| 9                | 16.01.2024 | 523,412           |
| 10               | 16.01.2024 | 93,996            |
| 11               | 16.01.2024 | 155,764           |
| 12               | 16.01.2024 | 3,023,200         |
| 13               | 16.01.2024 | 305,094           |
| 14               | 16.01.2024 | 4,179,390         |
| 15               | 16.01.2024 | 1,471,898         |
| 16               | 16.01.2024 | 69,270            |
| 17               | 16.01.2024 | 427,112           |
| 18               | 16.01.2024 | 208,018           |
| 24               | 17.01.2024 | 2,558,045         |
| 49               | 23.01.2024 | 52,494            |
| <b>TOTALI</b>    |            | <b>22,388,365</b> |

Lëvizjet e llogarisë 42 "Detyrime ndaj personelit", viti 2023

| Lëvizjet e llogarisë 42 "Detyrime ndaj personelit" |            |
|--|------------|
| Celje e vitit 2023                                 | 15,709,088 |

|                                  |                   |
|----------------------------------|-------------------|
| Shtesa (K)                       | 251,054,188       |
| Pakesime (D)                     | 244,374,912       |
| <b>Gjendja në 31.12.2023 (K)</b> | <b>22,388,364</b> |

- **Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, është paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **1,014,473** lekë.

*Llogara analitike 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, viti 2023*

| Urdhër shpenzimi |            | Vlera në lekë    |
|------------------|------------|------------------|
| Nr.              | Datë       |                  |
| 24               | 17.01.2024 | 1,014,473        |
|                  | -          | -                |
| <b>TOTALI</b>    |            | <b>1,014,473</b> |

*Lëvizjet e llogarisë 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, viti 2023*

| <b>Lëvizjet e llogarisë 431 "Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa"</b> |                  |
|---|------------------|
| <b>Celje e vitit 2023</b>   | 731,668          |
| Shtesa (K)  | 10,563,952       |
| Pakesime (D)  | 10,281,147       |
| <b>Gjendja në 31.12.2023 (K)</b>  | <b>1,014,473</b> |

- **Llogaria 435 “Sigurime Shoqërore”**, është paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **3,363,134** lekë.

*Llogara analitike 435 “Sigurime Shoqërore”, viti 2023*

| Urdhër shpenzimi |            | Vlera në lekë    |
|------------------|------------|------------------|
| Nr.              | Datë       |                  |
| 25               | 17.01.2024 | 3,363,134        |
|                  | -          | -                |
| <b>TOTALI</b>    |            | <b>3,363,134</b> |

*Lëvizjet e llogarisë 435 “Sigurime Shoqërore”, viti 2023*

| <b>Lëvizjet e llogarisë 435 "Sigurime Shoqërore"</b> |                  |
|--|------------------|
| <b>Celje e vitit 2023</b>                            | 4,920,102        |
| Shtesa (K)   | 36,342,537       |
| Pakesime (D)   | 37,899,505       |
| <b>Gjendja në 31.12.2023</b>                         | <b>3,363,134</b> |

- **Llogaria 436 “Sigurime Shëndetsore”**, është paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **381,151** lekë.

*Llogara analitike 436 “Sigurime Shëndetsore”, viti 2023*

| Urdhër shpenzimi |            | Vlera në lekë  |
|------------------|------------|----------------|
| Nr.              | Datë       |                |
| 26               | 17.01.2024 | 381,151        |
|                  | -          | -              |
| <b>TOTALI</b>    |            | <b>381,151</b> |

*Lëvizjet e llogarisë 436 “Sigurime Shëndetsore”, viti 2023*

| <b>Lëvizjet e llogarisë 436 "Sigurime shendetesore"</b> |           |
|---|-----------|
| <b>Celje e vitit 2023</b>                               | 316,307   |
| Shtesa (K)  | 4,130,825 |
| Pakesime (D)  | 4,065,981 |

|                       |         |
|-----------------------|---------|
| Gjendja në 31.12.2023 | 381,151 |
|-----------------------|---------|

- **Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”**, është paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **58,864,382** lekë.

Llogara analitike 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, viti 2023

| Nr.   | Nr. USH | Data       | Përshkrimi  | Vlera në lekë     |
|---|---------|------------|---|-------------------|
| <b>Vlera në fund të vitit 2022 (1)</b>                      |         |            |   | <b>53,872,657</b> |
| 1   | 82      | 15.02.2023 | Rikonstrukcion Muzeu Qytetit dhe Sistemim I Sheshit Perpara   | 562,405           |
| 2   | 83      | 15.02.2023 | Sistemim asfaltim rrugeve Bashkia Bulqize   | 1,929,491         |
| 3   | 84      | 15.02.2023 | Rikonstrukcion Fusha e Futbollit(Ndertim I dhomave te zhveshjes se Futbollisteve)   | 279,783           |
| 4   | 94      | 21.02.2023 | Ndertim tombino dhe mure ne fshatin Vlashe  | 119,796           |
| 5   | 144     | 10.03.2023 | Rikonstrukcion total I Rrjetit te Furnizimit me uje te Qytetit Bulqize dhe Rrjeti Shperndares I Qytetit te Ri Bulqize Faza II "     | 1,500,000         |
| 6   | 204     | 19.04.2023 | Sistemim asfaltim I rruges Ura e Serbinit -Shtushaj „Shupenze"  | 750,000           |
| 7   | 208     | 20.04.2023 | Ndertim rrjeti shperndares I fshatrave Gjorice si dhe ndertim Depo uji faza 2 "   | 511,295           |
| 8   | 241     | 09.05.2023 | Sistemim asfaltim I Rruges Lagjia Kulla(Okshatine)  | 180,918           |
| 9   | 247     | 11.05.2023 | Sistemim asfaltim I rruges se fshatit Topojan   | 247,714           |
| 10  | 250     | 17.05.2023 | Ndertim I Tregut Bujqesor dhe Blektorial ne Lagjen Minatori Bulqize "   | 421,076           |
| 11  | 251     | 17.05.2023 | Sistemim Asfaltim I Rruges se fshatit Peladhi   | 195,004           |
| 12  | 318     | 16.06.2023 | Sistemim asfaltim I rruges Ura e Serbinit -Shtushaj, Shupenze   | 300,000           |
| 13  | 319     | 19.06.2023 | Sistemim asfaltim I rruges fshati Topojan   | 50,000            |
| 14  | 320     | 19.06.2023 | Sistemim asfaltim I rruges se fshatit Peladhi   | 50,000            |
| 15  | 321     | 19.06.2023 | Sistemim asfaltim I rruges Bashkia Bulqize  | 1,345,161         |
| 16  | 377     | 19.07.2023 | Sistemim asfaltim I Rruges Lagjia Kulla(Okshatine)  | 313,476           |
| 17  | 371     | 17.07.2023 | Ndertim tombino dhe mure ne fshatin Smollik dhe Ternove e Vogel"  | 118,480           |
| 18  | 337     | 11.07.2023 | Sistemim asfaltim I rruges se fshatit Bllace,Nj.Ad.Shupenze (Loti I )   | 350,188           |
| 19  | 338     | 11.07.2023 | Sistemim asfaltim I rruges se Varezave,qyteti Bulqize   | 250,000           |
| 20  | 428     | 06.09.2023 | "Ndertim Sistemim Kanalizimesh dhe impianti trajtim te ujerave te ndotura necqytetin Bulqize Lagjia e Re"                           | 1,827,752         |
| 21  | 462     | 12.09.2023 | Sistemim asfaltim I rruges Ura e Serbinit -Shtushaj, Shupenze   | 300,000           |
| 22  | 517     | 11.10.2023 | Ndertim rrjeti furnizimi dhe rrjeti shperndares ujesjellesi lagjia Allmete dhe ndertim I rrjetit KUZ Lagjia e vjeter,Qyteti Bulqize | 1,073,522         |
| 23  | 555     | 06.11.2023 | Sistemim asfaltim I rruges se fshatit Sopot Loti II   | 503,446           |
| 24  | 556     | 06.11.2023 | "Ndertim Sistemim Kanalizimesh dhe impianti trajtim te ujerave te ndotura necqytetin Bulqize Lagjia e Re"                           | 1,072,248         |
| 25  | 593     | 14.11.2023 | Rehabilitim Kanali ujites (Sifoni ) Vajkal  | 375,144           |
| 26  | 613     | 21.11.2023 | Sistemim asfaltim I rruges Ura e Serbinit-Shtushaj,Shupenze   | 250,000           |
| 27  | 627     | 04.12.2023 | Ndertim rrjeti shperndares I fshatrave Gjorice si dhe ndertim Depo uji faza 2 "   | 1,238,705         |
| 28  | 668     | 18.12.2023 | Ndertim I terreneve sportive prane shkolles 9-vjecare "Xhevdet Doda "   | 101,022           |
| 29  | 669     | 18.12.2023 | Sistemim asfaltim I rruges se Krajke e Siperme Nj.Ad.Zerqan   | 130,000           |
| 30  | 687     | 20.12.2023 | Sistemim asfaltim I rruges Ura e Serbinit-Shtushaj,Shupenze   | 226,910           |
| 31  | 704     | 26.12.2023 | Sistemim asfaltim I rruges fshati Topojan   | 190,648           |
| 32  | 705     | 26.12.2023 | Sistemim asfaltim I rruges se fshatit Peladhi   | 111,828           |
| 33  | 719     | 28.12.2023 | Sistemim asfaltim I Rruges Lagjia Kulla(Okshatine)  | 51,366            |
| 34  | 720     | 29.12.2023 | Rikonstrukcion total I Rrjetit te Furnizimit me uje te Qytetit Bulqize dhe Rrjeti Shperndares I Qytetit te Ri Bulqize Faza II "     | 4,944,245         |
| 35  | 722     | 29.12.2023 | "Ndertim Sistemim Kanalizimesh dhe impianti trajtim te ujerave te ndotura ne qytetin Bulqize Lagjia e Re"                           | 2,500,000         |
| <b>TOTALI (2)</b>   |         |            |   | <b>24,371,623</b> |
| <b>Likuiduar në vitin 2023 (3)</b>                          |         |            |   | <b>19,379,898</b> |
| <b>TOTALI QË TRASHËGOHET PËR VITIN 2024 (1) + (2) – (3)</b> |         |            |   | <b>58,864,382</b> |

- **Llogria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”**, është paraqitur në mbyllje të vitit ushtrimor në vlerën **196,078,874** lekë.

## **Pasqyra e Performancës Financiare**

Nga analizimi i Pasqyrës së Performancës Financiare, në fund të vitit ushtrimor 2023 vlera e të ardhurave të gjeneruara (llogaritë e klasës 7) ka qenë **1,043,909,487** lekë, ndërsa vlera e shpenzimeve të kryera (llogaritë e klasës 6) ka qenë në vlerën **843,250,814** lekë. Diferenca ndërmjet tyre në vlerën 200,658,673 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore”.

### **Llogaritë e klasës 7 – Të ardhurat**

- **Llogaria 70 “Të ardhura nga taksat e tatimet”**, për vitin 2023, është paraqitur në pasqyrën e performancës financiare në vlerën **13,131,298** lekë dhe përbëhet nga:
  - Llogaria 700 “Tatimi mbi të Ardhurat” në vlerën 162,177 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.
  - Llogaria 702 “Tatimi mbi pasurinë” në vlerën 5,164,832 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.
  - Llogaria 703 “Tatime mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit” në vlerën 7,804,289 lekë, e cila nuk rakordon me akt rakordimin e thesarit, në të cilin vlera e kësaj llogarie është paraqitur 7,809,289 lekë. Diferenca në vlerën 5,000 lekë.
- **Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”**, për vitin 2023, është paraqitur në pasqyrën e performancës financiare në vlerën **49,074,861** lekë. Vlera e llogarisë 71 përbëhet nga:
  - Llogaria 710 “Nga ndërmarrjet dhe pronësia” në vlerën 8,708,912 lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.
  - Llogaria 711 “Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare”, në vlerën 40,365,949 lekë, e cila nuk rakordon me akt rakordimin e thesarit, në të cilin vlera e kësaj llogarie është paraqitur 40,360,950 lekë. Diferenca në vlerën 5,000 lekë.  
**Shënim:** Diferenca prej 5,000 lekë e llogarisë 711 mbyllet me diferencën e konstatuar në llogarinë 703.
- **Llogaria 72 “Grante korente”**, për vitin 2023 paraqitet në pasqyrën e performancës për vlerën **981,703,328** lekë dhe përbëhet nga:
  - Llogaria 720 “Grant korent i Brendshëm” në vlerën 977,615,284 lekë.
  - Llogaria 721 “Grant korent i Huaj” në vlerën 4,088,044 lekë.  
**Shënim:** Përsa i takon llogarisë 72 “Grante korente” nuk disponohet një akt rakordim me thesarin për vitin 2023.

*Përbërja e llogarisë 720 “Grant korent i Brendshëm”, viti 2023*

| <b>720</b>    | <b>Grant korent i Brendshëm</b>                            | <b>Vlera në lekë</b> |
|---------------|--|----------------------|
| <b>7200</b>   | Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)                             | 922,011,244          |
| <b>7201</b>   | Nga Buxheti per NJQP(Vendore)                              | 17,878,996           |
| <b>7202</b>   | Nga Buxheti per pagesa te posacme te ISSH                  | -                    |
| <b>7203</b>   | Nga Buxheti per mbulim deficiti(ISSH E ISKSH)              | -                    |
| <b>7204</b>   | Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale            | -                    |
| <b>7205</b>   | Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit | -                    |
| <b>7206</b>   | Financim i pritshem nga buxheti                            | 37,725,044           |
| <b>7207</b>   | Sponsorizime te brendshme (nga te trete)                   | -                    |
| <b>7209</b>   | Te tjera grante korente te brendshme                       | -                    |
| <b>TOTALI</b> |  | <b>977,615,284</b>   |

Përbërja e llogarisë 721 "Grant korent i Huaj", viti 2023

| 721           | Grant korent i Huaj          | Vlera në lekë    |
|---------------|------------------------------|------------------|
|               | Nga Qeveri te Huaja          | 4,088,044        |
|               | Nga Organizata Nderkombetare | -                |
| <b>TOTALI</b> |                              | <b>4,088,044</b> |

- Llogaritë e klasës 7 në datën 31.12.2023, bazuar në akt rakordimin me thesarin, kanë rezultuar në vlerën totale prej **115,781,528** lekë. Detajimi analitik i kësaj llogarie (Aneksi, Rakordimi për llogaritë e klasës 7, viti 2023).

### **Konkluzion:**

Nga auditimi ka rezultuar se totali i llogarive të klasës 7 në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2023, është paraqitur në vlerën **1,043,909,487** lekë, duke mos rezultuar në të njëjtën vlerë me akt rakordimin e thesarit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës, si dhe në mungesë të akt rakordimit të kërkuar për llogarinë 72 "Grante korent". Ky veprim është në mospërputhje me Ligjin nr. 25/2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", neni 11, pika 1; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", të ndryshuar, Kapitulli III, pika 24; Ligjin 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

### **Llogaritë e klasës 6 - Shpenzimet**

**Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve"**, në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën **262,212,642** lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.

Llogaria 600 "Pagat dhe përfitimet e punonjësve", viti 2023

| 600           | Pagat dhe përfitimet e punonjësve | Vlera në lekë      |
|---------------|-----------------------------------|--------------------|
| 6001          | Paga, personel i perhershëm       | 261,886,498        |
| 6002          | Paga personel i Perkohshëm        | -                  |
| 6003          | Shperblime                        | 326,144            |
| 6009          | Shpenzime te tjera per personelin | -                  |
| <b>TOTALI</b> |                                   | <b>262,212,642</b> |

**Llogaria 601 "Kontribute të sigurimeve"**, në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën **40,489,428** lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.

"Kontribute të sigurimeve", viti 2023

| 601           | Kontribute të sigurimeve             | Vlera në lekë     |
|---------------|--------------------------------------|-------------------|
| 6010          | Kontributi i Sigurimeve Shoqerore    | 36,357,989        |
| 6011          | Kontributi i Sigurimeve Shendetesore | 4,131,439         |
| <b>TOTALI</b> |                                      | <b>40,489,428</b> |

**Llogaria 602 "Blerje mallra e shërbime"**, në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën **138,786,788** lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.

Llogaria 602 "Blerje mallra dhe Shërbime", viti 2023

| 602  | Blerje mallra e shërbime         | Vlera në lekë |
|------|----------------------------------|---------------|
| 602  | Mallra dhe shërbime të tjera     | -             |
| 6020 | Materiale zyre e të përgjithshme | 1,916,937     |

|               |   |                    |
|---------------|---|--------------------|
| <b>6021</b>   | Materiale dhe shërbime speciale             | 14,934,651         |
| <b>6022</b>   | Shërbime nga të tretë                       | 65,582,406         |
| <b>6023</b>   | Shpenzime transporti                        | 21,994,159         |
| <b>6024</b>   | Shpenzime udhëtimi                          | 2,401,548          |
| <b>6025</b>   | Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme      | 10,104,659         |
| <b>6026</b>   | Shpenzime për qeramarrje                    | 6,456,100          |
| <b>6027</b>   | Shpenzime për detyrime për kompesime legale | 7,984,860          |
| <b>6028</b>   | Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua  | -                  |
| <b>6029</b>   | Shpenzime të tjera operative                | 7,411,468          |
| <b>TOTALI</b> |   | <b>138,786,788</b> |

**Llogaria 604 “Transferime korente të brendshme”,** në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën **9,308,242** lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.

*“Transferime korente të brendshme”, viti 2023*

| <b>604</b>    | <b>Transferime korente të brendshme</b>                     | <b>Vlera në lekë</b> |
|---------------|---|----------------------|
| <b>6040</b>   | Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise            | 9,308,242            |
| <b>6041</b>   | Transferime korente tek institucione qeveritare te ndryshme | -                    |
| <b>6042</b>   | Transferime korente tek Sigurimet Shoqerore e Shendetesore  | -                    |
| <b>6044</b>   | Transferime korente tek Organizatat jo fitimprurse          | -                    |
| <b>TOTALI</b> |   | <b>9,308,242</b>     |

**Llogaria 606, “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”,** në pasqyrën e performancës financiare është paraqitur në vlerën **403,639,597** lekë, e cila rakordon me akt rakordimin e thesarit.

*Llogaria 606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”, viti 2023*

| <b>606</b>    | <b>Transferime për Buxhetet familjare e Individë</b> | <b>Vlera në lekë</b> |
|---------------|--|----------------------|
| <b>6060</b>   | Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH               | -                    |
| <b>6061</b>   | Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor | 403,639,597          |
| <b>TOTALI</b> |  | <b>403,639,597</b>   |

***Për sa më sipër, për periudhën objekt auditimi ngarkohen me përgjegjësi: Kryetari i Bashkisë Bulqizë në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. F.M; Drejtori i Financës, në cilësinë e nëpunësit zbatues të institucionit, z. R. B; dhe Përgjegjësja e Financës, znj. Sh.O.***

#### **4. AUDITIM MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE MBI ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE (ASETE DHE PYJE E KULLOTA) TË TRASNFERUARA SIPAS VKM.**

Në zbatim të pikes 4 të programit të auditimit: *“ Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Asete dhe Pyje Kullotave) të trasnferuara sipas VKM” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:*

1. Inventarët e aseteve të kaluara me VKM Bashkisë dhe NJA nga Pushteti Qendror.
2. Listat e aseteve të kaluara në pronësi të Bashkisë së bashku me certifikatat hipotekore sipas rastit, si dhe lista e aseteve për të cilat janë përgatitur dokumentet tekniko-ligjore të depozituar në ASHK për pajisjen e Bashkisë me certifikatë hipotekore pronësie për këto asete.

***Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:***

- Asetet e kaluara nga pushteti qendror pranë Bashkisë Bulqizë paraqiten, sipas VKM-ve
- Për **Bashkinë Bulqizë** (Bashkia Qendër) është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Bulqizë, me VKM nr. 5, datë 04.01.2013, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Bulqizë, Qarku Dibër, sipas lidhjes nr. 1 me 64 fletë dhe përmbajtje 70 prona, ndryshuar me VKM nr. 816, datë 24.12.2021 “Për disa shtesa në VKM nr. 5, datë 04.01.2013”, ku shtohen pronat me nr 378-479.
- Për **Komunën Zerqan** është miratuar lista përfundimtare e pronave me VKM nr. 809, datë 06.10.2010, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Zerqan, Qarku Dibër”, me 89 prona.
- Për **Komunën Fushë-Bulqizë** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 480, datë 30.05.2013, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Fushë Bulqizë, Qarku Dibër”, me 508 prona.
- Për **Komunën Martanesh** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 523, datë 12.03.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Martanesh të Qarkut Dibër me listë inventari me 111 fletë përmbajtje 155 prona.
- Për **Komunën Trebisht**, është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 903, datë 21.12.2011, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose përdorim të komunës Trebisht, Qarku Dibër”, me 156 prona.
- Për **Komunën Gjoricë** është miratuar lista e inventarit me VKM nr.124, datë 02.02.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Gjoricë të qarkut Dibër me 32 fletë dhe përmbajtje 176 prona.
- Për **Komunën Ostren** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 160, datë 27.02.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Ostren të qarkut Dibër me 47 fletë dhe përmbajtje 145 prona.
- Për **Komunën Shupenzë** është miratuar lista e inventarit me VKM nr.483, datë 30.05.2013 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Komunës Shupenzë të qarkut Dibër me 32 fletë dhe përmbajtje 152 prona

|                 | VKM   |            | Në pronësi | Në përdorim | Regjistruar |
|-----------------|-------|------------|------------|-------------|-------------|
|                 | Numër | Datë       |            |             |             |
| Bashkia Bulqizë | 5     | 04.01.2013 | 53         | 15          | 86          |

|                                 | VKM   |            | Në pronësi | Në përdorim | Regjistruar |
|---------------------------------|-------|------------|------------|-------------|-------------|
|                                 | Numër | Datë       |            |             |             |
| <i>Komuna Zerqan</i>            | 809   | 06.10.2010 | 72         | 26          | 5           |
| <i>Komuna Fushë<br/>Bulqizë</i> | 480   | 30.05.2013 | 585        | 18          | 4           |
| <i>Komuna Martanesh</i>         | 523   | 30.06.2010 | 119        | 29          | 1           |
| <i>Komuna Trebisht</i>          | 903   | 21.12.2011 | 28         | 12          | -           |
| <i>Komuna Gjoricë</i>           | 124   | 02.02.2009 | 201        | 657         | 1           |
| <i>Komuna Ostren</i>            | 160   | 27.02.2013 | 63         | 37          | 2           |
| <i>Komuna Shupenzë</i>          | 483   | 30.05.2013 | 126        | 26          | 4           |
| <i>Total</i>                    |       |            | 1247       | 820         | 103         |

Nga auditimi rezulton se referuar inventarit të aseteve, Bashkia Bulqizë zotëron në total 2067 asete, nga të cilat 1247 në pronësi dhe 820 në përdorim. Nga Lista e aseteve të kaluara në pronësi, rezulton se Bashkia Bulqizë ka të regjistruara dhe pajisur me çertifikatë vetëm 103 asete ose 7% të aseteve si në aneksin bashkëlidhur.

Për asetet e mbetura, Bashkia Bulqizë nuk kryen inventarizim periodik të tyre, duke mos patur informacion për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, dëmtuara etj. Ndërkohë nuk rezulton të jenë marrë masa as për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të tyre për të vijuar me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18, 22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, invenatrizimi, transferimi dhe rregjistrimi i pronave të paluajtshme publike”nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 ”Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”.

**Sa i takon Pyjeve dhe Kullotave**, në bazë të VKM nr. 433 datë 8.6.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-Komunave/Bashkive”, Bashkisë Bulqizë i takojnë asetet sipas shtojces nr.7 bashkëlidhur ketij vendimi, që fillojnë me nr. rendor 1 (një) deri në 2236, si dhe godina e DShP.

Për sa më lart Bashkisë Bulqizë i janë kaluar në pronësi në total 43209.66 ha pyje e kullota, nga të cilat 32751.6 ha pyje, 6048.6 ha kullota, 173.25 ha bimësi pyjore dhe 4236.21 ha shkëmbore dhe ujore.

Nga auditimi rezulton se nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve nuk janë marrë masa për regjistrimin në DVASHK Dibër të këtyre sipërfaqeve dhe as nuk ka plane menaxhimi apo mbarështimi për to, në kundërshtim me nenet 5, 6 dhe 15 pika 2, të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” dhe me Manualin e Mbarështimit të Pyjeve.

Për periudhën objekt auditimi, rezulton se Bashkia Bulqizë ka lidhur 3 kontrata për dhënie me qera të fondit pyjor si vijon:

- Kontrata me nr. 2819, datë 07.06.2023 me subjektin G sh.p.k për dhënien me qëra nga fondi pyjor/kullor të sipërfaqes prej 11 ha, pjesë e ngastrave 14/a dhe 14/b në ekonominë pyjore Shupenzë për ndërtim panelesh fotovoltaik për prodhim energjie elektrike me vlerë vjetore 1,573,000 lekë.
- Kontrata me nr. 3150, datë 16.06.2023 me subjektin E.sh.p.k për dhënien me qëra nga fondi pyjor/kullor të sipërfaqes prej 3.51 ha, pjesë e ngastrave 12/f në ekonominë pyjore “Liqenet e Bulqizës” për ushtrimin e veprimtarive me qëllim pushimi, argëtimi, veprimtari kampingje, etj me vlerë vjetore 289,575 lekë.
- Kontrata me nr. 6941, datë 30.11.2023 me subjektin Z. Tp për dhënien me qëra nga fondi pyjor/kullor të sipërfaqes prej 2.6 ha, pjesë e ngastrave 100/b dhe 83/a në ekonominë pyjore “Shesh-Bulqizë” për ushtrimin e veprimtarive me qëllim agroturizëm, shtëpi pritëse, veprimtari kampingje, etj me vlerë vjetore 251,515 lekë.

Nga auditimi rezulton se sipërfaqet e mësipërme janë dhënë në përdorim në kundërshtim me pikën 3/b të Udhëzimit nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pasi Bashkia Bulqizë nuk ka plane menaxhimi për këto sipërfaqe.

*Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi zj. F. M dhe z. U.H*

### **III. GJETJE DHE REKOMANDIME**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se, vlera e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit 2022 ka qenë 7,078 mijë lekë. Gjatë vitit 2023 nuk ka pasur pagesa për këto detyrime, si dhe nuk janë krijuar detyrime të reja, duke rezultuar në një vlerë të detyrimeve të prapambetura deri 31.12.2023 në vlerën 7,078 mijë lekë.

Referuar totalit të shpenzimeve për vitin 2023 dhe vlerës së faturave të palikujduara, Bashkia Bulqizë klasifikohet në Bashkitë pa vështirësi financiare.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017 "Për financat e qeverisjes vendore", neni 34, pika 1, neni 40, pika 3; Udhëzimi nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”, pika 5 dhe pika 8. Udhëzimi i MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 101.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1 në faqet 10-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Bulqizë, Drejtoria e Financës, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plane të detajuara për këtë qëllim dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se referuar inventarit të aseteve, Bashkia Bulqizë zotëron në total 2067 asete, nga të cilat 1247 në pronësi dhe 820 në përdorim. Nga Lista e aseteve të kaluara në pronësi, rezulton se Bashkia Bulqizë ka të regjistruara dhe pajisur me çertifikatë vetëm 103 asete ose 7% të aseteve. Për asetet e mbetura, Bashkia Bulqizë nuk kryen inventarizim periodik të tyre, duke mos patur informacion për gjendjen e tyre, nëse janë ende ekzistente, të zaptuara, dëmtuara etj. Ndërkohë nuk rezulton të jenë marrë masa as për përgatitjen e dokumentacionit tekniko-ligjor të tyre për të vijuar me procesin e aplikimit dhe regjistrimit të tyre. Sa i takon Pyjeve dhe Kullotave, Bashkisë Bulqizë i janë kaluar në pronësi në total 43209.66 ha pyje e kullota, nga të cilat 32751.6 ha pyje, 6048.6 ha kullota, 173.25 ha bimësi pyjore dhe 4236.21 ha shkëmbore dhe ujore. Nga auditimi rezulton se nga Drejtoria e Administrimit të Pyjeve nuk janë marrë masa për regjistrimin në DVASHK Dibër të këtyre sipërfaqeve dhe as nuk ka plane menaxhimi apo mbarështimi për to, në kundërshtim me nenet 5, 6 dhe 15 pika 2, të ligjit nr.9385, datë 04.05.2005, “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, udhëzimin nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” dhe me Manualin e Mbarështimit të Pyjeve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.4 në faqet 56-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Bulqizë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura pa regjistruar cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillojë përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me çertifikatë pronësie.

### Menjëherë

**3. Gjetje nga auditimi:** Në auditimi mbi saktësinë e llogarive 31 “Materiale” dhe 32 “Inventar i imët” të pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2023, u konstatua se:

- Nga të dhënat e vëna në dispozicion grupit të auditimit nga Drejtoria e Financës është konstatuar se nuk janë mbajtur llogari analitike për secilën nga këto llogari, duke e bërë të vështirë identifikimin se çfarë është përfshirë në llogarinë 31 dhe 32, si dhe lidhjen e tyre me vlerat në ditarin e magazinës.

- Nga llogaritjet e kryera nga grupi i auditimit, duke marrë në konsideratë vlerën totale të llogarive të klasës 3 për vitin 2023, të përbërë nga llogaria 31 dhe llogaria 32, kanë rezultuar diferencat përkatësisht në vlerat 452,864 lekë dhe 4,441,818 lekë. Ky fenomen ka sjellë një mbivlerësim të vlerave në pasqyrën e pozicionit financiar, për të dyja llogaritë.

- Nisur nga moskuadrimi dhe rrjedhimisht diferencat që kanë rezultuar, vihet re se gjendja në fund të vitit e llogarive të klasës 3, duke marrë parasysh gjendjen në fillim, hyrjet dhe daljet e paraqitura në ditarin e magazinës, nuk përkon me vlerën e tyre të paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar. Këto veprime janë në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar, Kapitulli III, pika 24; Ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit”.

(Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 25-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**3.1.Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat për krijimin dhe mbajtjen e llogarive analitike për llogaritë 31 “*Materiale*” dhe 32 “*Inventar i imët*”, pjesë e klasës 3 “*Gjendja e inventarit qarkullues*”, në mënyrë që të ketë një vlerë të identifikuar për secilën prej tyre, si dhe të paraqiten në mënyrë të saktë dhe reale vlerat e llogarive 31 “*Materiale*” dhe 32 “*Inventar i imët*” në pasqyrën e pozicionit financiar. Gjithashtu të kryhen sistemimet përkatëse për vlerat 452,864 lekë dhe 4,441,818 lekë, që i takojnë përkatësisht llogarive 31 dhe 32.

**Me mbylljen e pasqyrave viti 2024**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi saktësinë e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” të pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2023, u konstatua se:

- Sipas të dhënave të detajuara të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Financës, debitorët kanë rezultuar në vlerën 196,076,874 lekë, ndërsa në pasqyrën e pozicionit financiar llogaria 468 “*Debitorë të ndryshëm*” është paraqitur në vlerën 196,078,874 lekë. Këto dy vlera nuk kuadrojnë me njëra – tjetrën dhe si rrjedhojë diferenca rezulton në vlerën 2,000 lekë. Si rrjedhojë e këtij fakti rezulton se në mbyllje të vitit 2023 kjo llogari është mbivlerësuar në pasqyrën e pozicionit financiar, për këtë vlerë.

Veprime në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 25-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**4.1.Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat që të paraqiten në mënyrë të saktë dhe reale vlerat e llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” dhe të kryhet sistemimi i vlerës prej 2,000 lekë, me qëllim paraqitjen e gjendjes reale të kësaj llogarie.

**Me mbylljen e pasqyrave viti 2024**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi saktësinë e llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” dhe llogarisë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” të pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2023, u konstatua se:

Vlera prej 7,078,668 lekë që përfaqëson shpenzime të kryera që i përkasin periudhave të ardhshme (bazuar edhe në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare, pika 8) nuk është kontabilizuar si pjesë e llogarisë 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” me kundërparti llogarinë 467 “*Kreditorë të ndryshëm*”, por është kontabilizuar si pjesë e llogarive 401 – 408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” dhe llogarisë 520 “*Disponibilitete në Thesar*”, duke sjellë që llogaria 486 dhe 467 në mbyllje të vitit ushtrimor të rezultojnë në vlerë 0 lekë. Si rrjedhojë e këtij fakti gjendja e llogarive 486 dhe 467, në fund të vitit ushtrimor 2023, nuk është paraqitur në mënyrë reale në pasqyrën e pozicionit financiar, duke sjellë një nënvlerësim të të dyja llogarive (486 dhe 467) për këtë vlerë. Veprime në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar, pika 42.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 25-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**5.1.Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat që të kontabilizohet vlera prej 7,078,668 lekë dhe të kryhen veprimet e nevojshme në mënyrë që në fund të vitit ushtrimor të paraqiten në mënyrë të saktë gjendjet e llogarive 486 “*Shpenzime të periudhave të ardhshme*” dhe 467 “*Kreditorë të ndryshëm*” në pasqyrën e pozicionit financiar.

**Me mbylljen e pasqyrave viti 2024**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u evidentua se vlera totale prej 4,865,108 lekë, pjesë e llogarisë analitike 202 “*Studime dhe kërkime*”, e cila përbëhet nga studime dhe kërkime të trashëguara nga ish Komunat (sot Njësitë Administrative) në vlerën 3,116,847 lekë, si dhe nga studime e projektme të shtuara gjatë vitit 2022 në vlerën 1,748,261 lekë, është e pa analizuar dhe nuk ka informacion nëse këto projekte janë vënë në zbatim, duke sjellë ndikim në informacionin kontabël që paraqesin pasqyrat financiare në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 lidhur me aktiveve afatgjata jo materiale. Veprime në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” të ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 25-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**6.1.Rekomandimi:** Drejtorja e Financës në Bashkinë Bulqizë, të marrë masa që në vijimësi duke u bazuar në dokumentet përkatëse financiare dhe ligjore të saktësojë gjendjen e studimeve dhe projekteve përsa i takon llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, duke verifikuar, saktësuar dhe analizuar vlerën prej 4,865,108 lekë të paraqitur në pasqyrat financiare, si dhe të disponojë informacionin e nevojshëm lidhur me vënien në zbatim të këtyre projekteve dhe studimeve.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi saktësinë e llogarisë 210 “*Toka, troje, Terrene*” të pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2023, u konstatua se:

- Llogaria 210 “*Toka, troje, Terrene*”, në pasqyrën e pozicionit financiar të vitit 2023 është paraqitur në vlerën **4,926,397** lekë, si dhe në pasqyrën formati 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto*”, duke moskuadruar me vlerën që rezulton bazuar në detajimin analitik të kësaj llogarie (kosto historike në fund), si dhe duke sjellë paraqitjen e nënvlerësuar të kësaj llogarie për vlerën 267,179 lekë. Kjo për arsye se vlera prej 5,193,576 lekë që përfaqëson realisht totalin e kësaj llogarie, i është nënshtruar amortizimit me normë 5%, ndërkohë që kjo llogari nuk i nënshtrohet amortizimit. Veprime në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” të ndryshuar, pika 36.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 25-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**7.1.Rekomandimi:** Drejtorja e Financës në Bashkinë Bulqizë, të marrë masa që në vijimësi të paraqesë në mënyrë të saktë dhe reale gjendjen e llogarisë 210 “*Toka, troje, Terrene*” në mbyllje të vitit ushtrimor në pasqyrën formati 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata, vlera neto*” dhe në pasqyrën e pozicionit financiar, duke marrë në konsideratë që kjo llogari nuk i nënshtrohet amortizimit. Gjithashtu të realizohen sistemimet përkatëse për vlerën 267,179 lekë të kësaj llogarie.

**Me mbylljen e pasqyrave viti 2024**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi saktësinë e llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” të pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2023, u konstatua se:

- Llogaria 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*” sipas pasqyrës formati 7/b “*Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)*” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,886,853,478 lekë. Referuar detajimit analitik të kësaj llogarie u evidentua se, nuk është zbritur ende vlera prej 225,599,068 lekë për 1 (një) artikull të ujësjellës - kanalizime që i është transferuar UK Bulqizë, duke sjellë ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me aktivet

afatgjata materiale dhe të llogaritjes së amortizimit të tyre. Veprime në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85 dhe Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” të ndryshuar, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 25-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**8.1.Rekomandimi:** Bashkia Bulqizë, të marrë masa që të krijojë një grup pune me specialistë të fushës, me qëllim transferimin në shoqërinë “Ujësjellës Kanalizime” sh.a të 1 (një) artikulli të mbetur pjesë të inventarit të aktiveve, duke ndjekur procedurat e marrjes në dorëzim të firmosura nga të dy palët, si dhe të kryej veprimet kontabël në mbyllje të pasqyrave financiare duke zbritur e mbetur prej 225,599,068 lekë.

### Menjëherë dhe në vijimësi

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare mbi saktësinë e llogarisë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” të pasqyrës së pozicionit financiar të vitit 2023, u konstatua se:

- Llogaria 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” është paraqitur në pasqyrën formati nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 0 lekë, pas amortizimit të llogaritur për gjithë vlerën e aktiveve prej 11,955,591 lekë, që kanë qenë pjesë e kësaj llogarie. Evidentohet se nuk janë marrë masa për grupimin e këtyre mjeteve, si dhe nuk ka një person përgjegjës për to. Gjithashtu nuk është ngritur një grup pune për t’i vlerësuar për jashtë përdorimit pasi ato ekzistojnë ende fizikisht, edhe pse janë hequr nga kontabiliteti. Gjithashtu nuk është ngritur komision për asgjësimin dhe vlerësimin e tyre si mbeturinë apo skrap me qëllim shitjen për realizimin e të ardhurave për Bashkinë Bulqizë. Veprime në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 , 85, 109, 110 dhe 111.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 25-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**9.1.Rekomandimi:** Bashkia Bulqizë të marrë masa që për aktivet të cilat kanë qenë pjesë e llogarisë 24 “Aktive të Qëndrueshme të trupëzuara të dëmtuara” të konsideruara si mjete të dëmtuara për vlerën 11,955,591 lekë, të bëjë grupimin e tyre si dhe të ngrejë komision për asgjësimin dhe vlerësimin si mbeturinë (skrap) me qëllim shitjen e tyre duke realizuar të ardhura. Kjo si rrjedhojë edhe e faktit që këto aktive nuk figurojnë më si pjesë e kësaj llogarie në kontabilitet, pasi janë bërë veprimet e amortizimit total të tyre duke bërë që në fund të vitit 2023 këto aktive të rezultojnë në vlerën 0 lekë, pra të amortizuara totalisht.

### Menjëherë

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi saktësinë e llogaritjes së amortizimit të aktiveve, u konstatua se:

- Llogaritja e amortizimit të Aktiveve Afatgjata Materiale, pjesë e llogarisë 218 “Inventari ekonomik”, konkretisht orendi zyre janë llogaritur më normë 5%, ndërkohë që realisht e kanë normën e amortizimit 20%, duke sjellë një llogaritje jo të saktë të amortizimit total të kësaj llogarie.

- Llogaria 210 “Toka, troje, Terrene” i është nënshtruar amortizimit ndërkohë që është një llogari që, referuar edhe përmbajtjes së detajuar (analitike) të saj, nuk amortizohet.

- Përsa i takon llogarive 210, 212, 213 dhe 215 nisur nga vlerat që janë paraqitur si pakësime për këto llogari, te pasqyra formati nr.7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto

*historike)*”, pas intervistimit me stafin e Drejtorisë së Financës u konfirmua se vlerat përkatëse që janë paraqitur si pakësim i secilës prej këtyre llogarive, realisht janë sistemime / lëvizje midis llogarive dhe jo pakësime të tipit nxjerrje jashtë përdorimi si rezultat i procesit të inventarizimit (marrë këtu në konsideratë se procesi i inventarizimit për vitin 2023 nuk është realizuar). Pavarësisht këtij argumenti të paraqitur nga stafi i Drejtorisë së Financës, këto sistemime figurojnë si pakësime dhe si rrjedhojë e këtij kategorizimi, mbi pakësimet përkatëse të këtyre llogarive është llogaritur edhe amortizimi. Efekt ky që ka sjellë një nënvlerësim të paraqitjes së vlerës reale të amortizimit për vlerën 200,483,667 lekë. Në këtë rast sistemimet / lëvizjet midis llogarive, që të konsiderohen të tilla, nuk duhet të japin asnjë efekt në amortizimin e aktiveve. Veprime në mospërputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” të ndryshuar, pika 36.  
(*Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 25-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**10.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë, me qëllim paraqitjen reale të amortizimit dhe raportimit financiar të llogarive pjesë e klasës 21 “*Aktivet Afatgjata Materiale*”, të marrë masat që:

- Të llogaritet amortizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale duke përdorur normat e sakta të amortizimit sipas llojit specifik të aktivitetit dhe sipas rregullave të llogaritjes së tij, për secilën kategori aktivesh sipas kuadrit ligjor dhe udhëzimit përkatës.
- Të kryhen siç duhet dhe në mënyrë të qartë sistemimet / lëvizjet midis llogarive, duke u kujdesur që pas realizimit të tyre efekti të jetë 0 (zero), për aq kohë sa konsiderohen vetëm sistemime midis llogarive të aktiveve pjesë e llogarive të klasës 21 “*Aktivet Afatgjata Materiale*”.
- Të kryhet sistemimi për sa i takon vlerës 200,483,667 lekë duke u siguruar që amortizimi total i akumuluar i aktiveve në mbyllje të vitit ushtrimor të paraqitet në vlerë të saktë dhe reale.

#### **Me mbylljen e pasqyrave viti 2024**

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 në Bashkinë Bulqizë, bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar, Kapitulli IV Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pikat 73 – 120 dhe Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” i ndryshuar, rezultoi se:

- Procesi i inventarizimit në Bashkinë Bulqizë për vitin 2023 nuk është kryer, referuar gjithashtu faktit se nuk është hartuar asnjë urdhër për nisjen e këtij procesi dhe për vijimin me fazat e tjera si inventarizimi fizik, vlerësimi i gjitha aktiveve, si dhe nxjerrja jashtë përdorimi e më tej asgjësimi sipas nevojës.
- Si rrjedhojë e mosrealizimit të procesit të inventarizimit duke përfshirë të gjitha fazat e tij, nuk është hartuar dhe miratuar një raport i inventarizimit fizik, gjë e cila pengon edhe verifikimin e gjendjes konkrete të aktiveve, krahasuar me rezultatin e aktiveve në kontabilitet.
- Për sa i takon aktiveve të Bashkisë Bulqizë nuk është përgatitur dhe miratuar një regjistër aktivesh i përditësuar.
- Gjithashtu nuk është hartuar dhe miratuar një rregullore specifike për ndjekjen e procedurave të ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike.

(*Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 25-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**11.1.Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat që në vijimësi:

- Të kryhet procesi i inventarizimit duke mundësuar realizimin e të gjitha fazave të tij, si inventarizimi fizik, vlerësimi i gjendjes së aktiveve dhe nxjerrja jashtë përdorimit për aktivet sipas

nevojës, duke u bazuar në gjendjen e tyre reale të amortizimit, të evidentuar gjatë procesit të inventarizimit.

- Të hartohet dhe miratohet një regjistër aktivesh ku të paraqiten të gjitha aktivet që zotëron apo ka në administrim Bashkia Bulqizë, si dhe të hartohet një rregullore specifike për ndjekjen e procedurave të ruajtjes, mbrojtjes dhe nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë publike.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Bulqizë nga auditimi mbi saktësinë e llogarive 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, u konstatua se:

- Nga detajimi analitik i llogarisë 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, ka rezultuar se 2 (dy) zëra në vlerën 692,951 lekë nuk i përkasin këtij grupi të llogarive, pasi janë detyrime për paga dhe tatimet për paga. Gjithashtu evidentohet se në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit 2023, për 3 (tre) zëra në vlerën totale prej 7,078,668 lekë, theksohet se i përkasin llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, e cila ka si kundërparti llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Pra këto zëra nuk bëjnë pjesë në llogaritë 401 – 408. Si rrjedhojë e këtij fakti, rezulton se grupi i llogarive 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është mbivlerësuar për vlerën totale prej 7,771,619 lekë. Veprime në mospërputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” të ndryshuar, pika 3.3 Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4).

*(Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 25-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**12.1.Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat që të kryhen sistemimet përkatëse për vlerën 7,771,619 lekë, si dhe të paraqitet në mënyrë të sakte dhe reale gjendja e llogarive 401 – 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit ushtrimor.

**Me mbylljen e pasqyrave viti 2024**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi saktësinë e llogarive të klasës 7 në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2023, u konstatua se:

- Vlera totale e llogarive të klasës 7 në pasqyrën e performancës financiare për vitin 2023, është paraqitur në vlerën 1,043,909,487 lekë, duke mos rezultuar në të njëjtën vlerë me akt rakordimin e thesarit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Financës. Veprime në mospërputhje me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, të ndryshuar, Kapitulli III, pika 24; Ligjin 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; dhe Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

*(Trajtuar më hollësisht në pikën III.3, faqe 25-56, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

**13.1.Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Financës në Bashkinë Bulqizë të merren masat që në vijimësi të paraqiten në mënyrë të saktë dhe reale vlerat e llogarive të klasës 7 në pasqyrën e performancës financiare, në mënyrë që të kuadrojnë me akt-rakordimet e thesarit.

**Me mbylljen e pasqyrave viti 2024**

**14. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, rezulton se Bashkia Bulqizë ka lidhur 3 kontrata për dhënie me qera të fondit pyjor, konkretisht me objekt prodhim energjie elektrike me vlerë vjetore 1,573,000 lekë, për ushtrimin e veprimtarive me qëllim pushimi, argëtimi, veprimtari kampingje, etj. me vlerë vjetore 289,575 lekë, si dhe për ushtrimin e veprimtarive me qëllim agroturizëm, shtëpi pritëse, veprimtari kampingje, etj. me vlerë vjetore 251,515 lekë.

Nga auditimi rezulton se sipërfaqet e mësipërme janë dhënë në përdorim në kundërshtim me pikën 3/b të Udhëzimit nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, pasi Bashkia Bulqizë nuk ka plane menaxhimi për këto sipërfaqe.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.4 në faqet 56-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1 Rekomandimi:** Sektori përgjegjës për menaxhimin e pyjeve dhe kullotave pranë Bashkisë Bulqizë, të marrë masa për hartimin e planeve të menaxhimit apo mbarështimit për secilën prej ngastrave që ka në pronësi përpara dhënies së tyre në përdorim, si dhe të lidhë kontratat për dhënie në përdorim duke respektuar llojin e përdorimit të planifikuar në plane menaxhimi.

**Në vijimësi**

## **B. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit ligjor për arkëtimin e debitorëve nga taksa dhe tarifa vendore, rezulton se në fund të vitit 2023 janë gjithsej debitorë në vlerën 99,933,852 lekët të cilët përbëhen nga:

- 883 subjekte private në vlerën 80,256,366 lekë;

- 4298 familje për taksë toke, taksë ndërtese etj, në vlerën 19,677,486 lekë.

Nga 883 subjektet debitore në vlerën 80,256,366 lekë, janë aktiv 306 subjekte ose 32 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa, në vlerën 46,762,485 lekë ose 60 % e vlerës së debitorëve. Për vitin 2023 rezulton se vlera debitore është shtuar me 8,490,431 lekë. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2, faqe 16-25 të Raportit të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e tyre në vlerën 99,933,852 lekë.

**Menjëherë**

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se nga vlera totale e debitorëve biznese e familjarë, nga taksa dhe tarifa vendore prej 99,933,852 lekë, kjo Drejtori ka njohur dhe dërguar pranë degës së financës për kontabilizim vetëm detyrime në vlerën 96,356,492 lekë, duke bërë që diferenca prej 3,577,360 lekë e pa kontabilizuar të konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Bulqizë.

**1.1 Rekomandimi:** Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave të marrin masa për identifikimin e saktë të listave të debitorëve, detyrimi i të cilëve nuk është kontabilizuar dhe të dërgojë pranë Drejtorisë së financës listat përkatëse për kontabilizimin e detyrimit prej 3,577,360 lekë.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se 9 subjekte ushtrajnë aktivitet të tregtimit të karburanteve me seli në territorin e Bashkisë Bulqizë, nga të cilët 2 nuk janë pajisur me Autorizim/Licenca për shitje karburanti, ndërsa nga 7 subjektet e tjerë, 3 prej tyre kanë likuiduar pjesërisht vlerën e plotë dhe 4 subjektet nuk kanë likuiduar detyrimet gjithsej në vlerën 5,800,000

lekë. Këto lista nuk rezultojn të jenë dërguar në fund të periudhës në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 5,800,000 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh” me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, neni 35, VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar kapitulli II, pika 1; germa “b”, dhe pika 9. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2, faqe 16-25 të Raportit të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa që me shkresë zyrtare të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim detyrimet e papaguara, si dhe për pajisjen me Autorizim/Licencë për shitje karburanti dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga 7 subjekte të vlerës 5,800,000 lekë.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga Aluizni Peshkopi janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ASHK Peshkopi. Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2023, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezultojn nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 44 persona me vlerë 1,273,024 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Bulqizë rezultojn se nga Drejtoria e të Ardhurave, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2, faqe 16-25 të Raportit të Auditimit).*

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa që me shkresë zyrtare të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim listat me vlerat e taksës së llogaritur dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 44 persona me vlerë 1,273,024 lekë.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga dhënia me qira e Pyjeve dhe Kullotave, u konstatua se 7 subjekte nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën 31,482,313 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Bulqizë. Nga Drejtoria e të Ardhurave, nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve, nuk është dërguar informacion Drejtorisë Juridike me qëllim ndjekjen e rrugëve ligjore për arkëtimin e detyrimeve deri në zgjidhjen e kontratave me subjektet sipas pasqyrës si më sipër, gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 31,482,313lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12, germa “g”, neni 22, pika 3, germa “dh” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2, faqe 16-25 të Raportit të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Bulqizë, Drejtoria e të Ardhurave, të marrë masa që me shkresë zyrtare të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim listat me vlerat e qirave të papaguara

dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin nga 7 subjekte të vlerës 31,482,313 lekë.

**Menjëherë**

#### **D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezulton se, gjatë vitit 2023 Bashkia Bulqizë ka patur detyrime për shlyerjen e vendimeve gjyqësore për largime nga puna të punonjësve dhe konkretisht 6 të tillë, ku 5 janë krijuar vetëm gjatë vitit 2023 në vlerën totale prej 10,327,923 lekë, me pasojë efekt financiar negativ për buxhetin e Bashkisë. Nga auditimi rezulton se për 5 vendimet e krijuara gjatë këtij viti është shlyer i gjithë detyrimi dhe nuk ka detyrime të prapambetura. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.1 në faqet 10-16 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Bulqizë të marrë masa që në të ardhmen, vendimet që lidhen me largimin nga puna të punonjësve të jetë të argumentuar, të mbështetur në ligj, si dhe të respektojnë afatet e njoftimit për largimin.

**Në vijimësi**

#### **E. MASA DISIPLINORE**

Për të gjithë punonjësit trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit. **Lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Bulqizë**, fillimi ose jo i procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

Për sa më sipër paraqitet Raporti Përfundimtar i Auditimit.

### **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

